



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 34 regjistër (JR)
Datë 18.07.2019

Nr. 1 i vendimit
Datë 12.01.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar
Ina Rama	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 12.01.2021, ditën e martë, në orën 10:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, gjyqtare/kryetare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 139, datë 15.04.2019.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha, të paraqitura në ankim, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 139, datë 15.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e gjyqtares/kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit iu nënshtrua procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “IKLD”), mbështetur në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016.
 - 2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar¹, duke konstatuar se:
 - i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2. DSIK-ja i dërgoi Komisionit raportin e kontrollit të figurës², duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.
 - 2.3. IKLD-ja ka rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe ka dërguar raportin³ në të cilin janë pasqyruar gjetjet dhe analiza e 8 (tetë) dosjeve gjyqësore.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 139, datë 15.04.2019, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha. Procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit u bazua në të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioni konstatoi si vijon.
 - 3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë – subjekti i rivlerësimit nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.
 - 3.2. Për kriterin e kontrollit të figurës – për subjektin e rivlerësimit nuk u gjetën indicie për kontakte që të ndikojnë në përshtatshmërinë ose jo për vazhdimin e detyrës.
 - 3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale – subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose të viktimave dhe është treguar efiçente dhe efektive në masë të pranueshme.

¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 08.01.2018.

² Shkresa nr. {***} prot., datë 02.11.2017.

³ Shkresa nr. {***} prot., datë 23.04.2018.

4. Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe, bazuar në nenet 58, pika 1, germa “c” e 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vendosi për shkarkimin e saj nga detyra.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim kundër vendimit të Komisionit⁴, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, në nenin F të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNj”), në nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim “K.Pr.Administrative”) dhe në nenin 46 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe konfirmimin në detyrë.
6. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji riçeljen e hetimit gjyqësor dhe zhvillimin e debatit publik për plotësimin e veprimeve të karakterit provues procedural, duke parashtruar argumentet në tri drejtime kryesore:
- treshja e njëjtë e anëtarëve të Komisionit ka hetuar dhe ka gjykuar procesin ndaj saj. Në funksion të këtij shkak, subjekti i rivlerësimit ngre çështje lidhur me cilësinë për sa u përket dijeve profesionale të hartuesve të 19 tabelave që pasqyrojnë analizën financiare në vendim, metodologjinë e ndjekur dhe saktësinë e shifrave për zërat e përzgjedhur. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon mungesa në arsyetim dhe analizë të deduksioneve logjike, duke u shprehur se argumentet e saj gjatë procesit kanë gjetur shumë pak vlerësim.
 - Legjislacioni i zbatueshëm përbën bazë ligjore “detyruese-përcaktuese” të veprimtarisë së Komisionit si “quasi” gjykatë administrative, i krijuar për shkak të pasojave që sjell tek individit ndaj të cilit merr vendimin dhe legjitimitetit të ankimit.
 - Përfundimet e Komisionit janë të kundërshtueshme pasi: a) janë të pambështetura në Kushtetutë dhe ligj dhe në kuadrin ligjor shoqërues mbi të cilin bazohet procesi i rivlerësimit; b) janë arritur në kushtet e mosmarrjes në konsideratë të të gjitha provave të depozituara gjatë hetimit dhe pas kalimit të barrës së provës; dhe c) të pabazuara në provat e administruara.
7. Shkaqet e ankimit të subjektit që lidhen kryesisht me interpretim të gabuar të legjislacionit, cenim të procesit të rregullt ligjor dhe vlerësim të gabuar të çështjeve të trajtuara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, përmbledhen si më poshtë.

7.1. Shkaqet e ankimit që lidhen me interpretimin e ligjit dhe cenimin e procesit të rregullt ligjor, në mënyrë të përmbledhur janë si vijojnë.

- Vendimi është rezultat i një hetimi administrativ të njëanshëm, të realizuar në kundërshtim me normat dhe parimet procedurale dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
- Vendimmarrja e Komisionit është njëanshme, e pabazuar në prova, e pabazuar në analizë të saktë financiare dhe e pabazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 17, 30, 31, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë argumentimi dhe analize juridike të gjetjeve dhe rrethanave konkrete.
- Për arsyet e mësipërme, Komisioni ka shkelur garancitë e nenit 6 të KEDNj-së, e për pasojë, vendimi është marrë në cenim të procesit të rregullt ligjor dhe të të drejtave të subjektit të rivlerësimit, dhe në shkelje të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016.

⁴ Regjistruar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 28.06.2019.

- Shkarkimi nga detyra është vendosur në kundërshtim me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk është vërtetuar ndonjë prej rasteve të parashikuara nga ky nen. Sjellja e subjektit në kuadrin e “deklarimit të pamjaftueshëm” duhet të ketë të njëjtin nivel kundërligjshmërie sikurse janë rastet e renditura në pikat 1, 2, 4 dhe 5 të këtij neni.
- Komisioni ka mbajtur standarde të ndryshme kuptimi dhe vlerësimi për qëllimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës në vendime të ndryshme, duke cenuar parimin e barazisë para ligjit të subjekteve të rivlerësimit.
- Konkluzioni i Komisionit lidhur me pasurinë, nuk qëndron në raport me gjetjet pozitive të figurës, *moralit* dhe aftësisë profesionale dhe mosvlerësimi i këtyre raporteve pozitive të institucioneve kompetente sjell shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë.
- Trupi gjykues i Komisionit është “organ akuzator” dhe “gjykatë” e, për rrjedhojë, nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, si element thelbësor i procesit të rregullt ligjor, në mbështetje të praktikës së GjEDNj-së.
- Mënyra e deklarimit të pasurive dhe të të ardhurave nuk ka qenë në atë nivel që të klasifikohet si sjellje e rëndë dhe e qëllimshme e që cenon besimin e publikut të funksionarët e drejtësisë, që të përligjte shkarkimin nga detyra sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Komisioni ka zbatuar gabim nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke cenuar qëllimin e ligjvënësit, qëllimin e ligjit në tërësi dhe të Kushtetutës. Kushtetuta nuk synon të largojë nga sistemi i drejtësisë personat që mund të kenë pasaktësi në deklaratimet e tyre, për të cilët nuk ka indicie për përfshirjen në veprimtari të paligjshme apo të papajtueshme me detyrën.

7.2. Shkaqet e ankimit që lidhen me shqyrtimin e kriterit të vlerësimit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë.

7.2.1. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme apartament me sipërfaqe 121,8 m², të ndodhur në Tiranë në rrugën “{***}”, e përfutuar me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.2007, në shumën 4.558.000 lekë, pjesë takuese 50%, subjekti i rivlerësimit pretendon se:*

- i. pasqyrimi i pasurisë është bërë në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, pasi në muajin gusht kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes dhe kanë likuiduar çmimin e blerjes, duke u bërë pronarë të pasurisë, marrë në dorëzim në janar të po këtij viti;
- ii. analiza financiare për vitet 1994 – 2001 nuk qëndron pasi nuk është kryer asnjë pagesë përgjatë kësaj periudhe sipas kontratës së sipërmarrjes. Vlera e apartamentit është likuiduar në muajin gusht 2007, përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, me burime financiare të ligjshme – mbështetur edhe në konkluzionin e ekspertit kontabël, të pasqyruar në përmbajtjen e ankimit. Eksperti kontabël ka marrë në konsideratë vërtetimet e lëshuara nga punëdhënësit e bashkëshortit dhe dokumentacionin ligjor të paraqitur gjatë procesit, i cili provon bindshëm marrëdhënien e punësimit dhe të ardhurat e ligjshme të krijuara.

7.2.2. *Lidhur me pasurinë e luajtshme [automjet të markës Toyota], të blerë nga bashkëshorti i subjektit në shumën prej 906.000 lekësh, më datë 07.10.2013, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka burime të ligjshme të të ardhurave për pasuritë e krijuara gjatë këtij viti, pasi balanca e fondeve për këtë vit është pozitive nëse përlllogariten (i) shpenzime jetese për 3 vetë në vitin 2013; dhe (ii) zbriten 20% për shpenzimet e transportit të cilat janë llogaritur si zë më vete; dhe (iii) përfshihen të ardhura nga qiraja, të deklaruara në deklaratën e interesave privatë.*

7.2.3. *Lidhur me depozitat bankare – arsyetuar në pikat 5, 6, 7, 8 dhe 9 të vendimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit pretendon se:*

- i. Për sa i përket krijimit të llogarive bankare [pika 5 dhe 6 e vendimit], balanca e fondeve është pozitive pasi vlera për shpenzimet e jetesës në analizën financiare për vitet 2014 dhe 2015, duhet të ndryshojë; shifra e dhënë nga Komisioni ka mungesë koherence, nuk i referohet asnjë burimi informacioni dhe shifrat e përdorura nuk kanë lidhje logjike në ndryshimet nga njëri vit në tjetrin.
- ii. Për sa i përket llogarisë së kursimit të bashkëshortit pranë Raiffeisen Bank [pika 8 e vendimit], përlllogaritja dhe metodologjia e hartimit të tabelave nga Komisioni është e saktë, por të ardhurat e përfituara duhet të përlllogariten sipas vërtetimeve nga dy shoqëritë, pasi detyrimin sipas legjislacionit për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi e ka punëdhënësi, siç referohet në dokumentacion dhe nga dispozitat ligjore, e vlerësuar kjo edhe në kontekstin e informalitetit në marrëdhënien e punësimit në realitetin shqiptar.
- iii. Për sa i përket analizës së gjendjes së *cash*-it dhe analizës financiare për periudhën 2005 – 2016 [pikat 9 dhe 10 të vendimit], Komisioni nuk përfshin balancat pozitive të vitit 2011 dhe 2016. Komisioni nuk i ka dhënë analizë financiare për sa u përket balancave negative për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2012, duke i mohuar mundësinë për t'i kundërshtuar rezultatet. Nëse do të ndryshoheshin vetëm të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit, sipas deklarimeve, rezultati do të ishte pozitiv në vlerën totale (+) 3.638.309 lekë, për vitet 2005 – 2010 dhe 2012 – 2015.
- iv. Komisioni gabon kur e trajton analizën financiare si një instrument ekzakt duke e konsideruar shkelje edhe vlerën negative 8.057 lekë.
- v. Diferenca negative e konkluduar nga Komisioni në vlerën 5.896.320 lekë, apo në vlerën 7.591.355 lekë, nuk i afrohet dyfishit të pasurisë totale, siç parashikon neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

7.2.4. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme tokë bujqësore me sip. 2,2 dynym, në emër të z. M. S., e përfituar sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", subjekti i rivlerësimit pretendon se:*

- i. konkluzioni i Komisionit për deklarin të pasaktë është i gabuar; familja bujqësore me kryefamiljar M. S. ka përfituar tokë arë në sasinë e deklaruar në deklaratën *vetting*, 2.200 m² dhe jo 2.400 m²;
- ii. mospasqyrimi i kësaj pasurie në deklaratën e interesave privatë për vitin 2003 ka ndodhur për shkak se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë jetuar në fshat pas martesë dhe nuk e kanë përdorur apo përfituar të ardhura nga kjo pasuri, çka e përjashton mundësinë për pasqyrim të qëllimshëm;
- iii. nuk ka asnjë përpjekje për të fshehur ose për të paraqitur në mënyrë të pasaktë këtë pasuri në bashkëpronësi të bashkëshortit me anëtarët e tjerë të familjes bujqësore të përfituar nga ligji nr. 7501/1991.

7.2.5. *Lidhur me gjetjen e Komisionit për ushtrimin e aktivitetit të bashkëshortit si ekspert topograf në gjykatë, subjekti i rivlerësimit pretendon se:*

- i. bashkëshorti i saj është angazhuar nga gjykata si ekspert në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurës Civile dhe në asnjë rast palët nuk kanë pasur pretendime në caktimin e tij;
- ii. gjatë periudhës 2016 – 2019, bashkëshorti është thirrur kryesisht nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, i përfshirë në listën e ekspertëve të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës;
- iii. pjesëmarrja e bashkëshortit nuk është e shpeshtë; pagesa për shërbimin e ofruar nuk është mbuluar nga buxheti i gjykatës, por nga palët ndërgjyqëse;

- iv. bashkëshorti nuk ka kryer asnjëherë aktivitet tregtar; për këtë arsye, nuk ka pasur detyrimin për t'u regjistruar pranë organit tatimor; për të ardhurat nga aktet e ekspertimit (të cilat zënë një përqindje shumë të vogël të të ardhurave të tij në total) është paguar tatimi në burim në vlerën prej 15% të pagesës bruto, i cili është më i lartë se vlera e detyrimeve tatimore që do të ishin paguar nëse do të ishte i regjistruar;
 - v. gjykatat kanë qenë në dijeni se bashkëshorti është i licencuar, por i paregjistruar në organet tatimore, duke e vlerësuar të rregullt situatën dhe duke e lejuar të kryejë ekspertimin përkatës;
 - vi. e ardhura për kryerjen e aktit të ekspertimit për çështjen nr. {***} akti, datë 01.07.2016, për të cilën është mbajtur tatimi në burim, ka kaluar në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortit dhe ka qenë e përfshirë në shumën e deklaruar në deklaratën e interesave privatë për vitin 2016; mospasqyrimi i mëvetëm i saj ka ndodhur për shkaqe harrese.
8. Bazuar në të gjitha provat e administruara, përgjigjet me shkrim dhe pohimet gjyqësore, aktin e ekspertimit dhe përmbledhjen përkatëse të përfshirë në ankim, subjekti i rivlerësimit kërkon në përfundim të ankimit:
- a) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike;
 - b) riçeljen e pjesshme të hetimit gjyqësor dhe realizimin e aktit të ekspertimit kontabël me grup ekspertësh;
 - c) ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 139, datë 15.04.2019;
 - ç) konfirmimin në detyrën e gjyqtarës, të deleguar për të kryer përkohësisht detyrën e kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
9. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur ankimit këto prova shoqëruese:
- raport teknik kontabël, datë 25.06.2019, hartuar nga eksperti R. L., kontabilist i miratuar, me kërkues av. Ardian Visha, për llogari të subjektit të rivlerësimit;
 - CD që përmban elektronikisht dosjen e krijuar nga hetimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit;
 - CD që përmban elektronikisht dosjen e krijuar prej subjektit të rivlerësimit në funksion të procesit të rivlerësimit.
10. Ankimi shoqërohet me prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.06.2019, nëpërmjet së cilës subjekti i rivlerësimit autorizon si përfaqësues ligjor av. Ardian Visha⁵.
11. Në zbatim të nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit paraqiti parashtime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim⁶, në përputhje me afatin 5-ditor para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi në Kolegji. Në përfundim të parashtimeve, subjekti i rivlerësimit parashtroi të njëjtat kërtime sikurse në ankim, detajuar në paragrafin 8 të këtij vendimi.

⁵ Nga prokura rezulton se subjekti i rivlerësimit ka autorizuar përfaqësuesin e saj të kryejë në mungesë të saj të gjitha procedurat e nevojshme për ankimin ndaj vendimit të Komisionit, përfaqësimin e saj në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, të parashtrojë kërkesa për çdo akt të nevojshëm, përfaqësimin pranë GjEDNJ-së, të drejtën për të kërkuar kopje aktesh, të paraqesë memo e kërkesa të tjera për marrje provash, si dhe të marrë pjesë në seanca dëgjimore për ta përfaqësuar subjektin me tagra të plota.

⁶ Parashtresat mbajnë datën 04.01.2021 dhe janë dërguar në rrugë elektronike dhe me shërbim postar, më datë 05.01.2012, regjistruar në Kolegji përkatësisht me nr. {***} prot., datë 05.01.2021 dhe nr. {***} prot., datë 06.01.2021.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit

12. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimit të Komisionit, që në këtë rast ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Ankuesja legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione temporis* në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se është subjekt rivlerësimi dhe ka depozituar ankimin brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit⁷. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë të dokumentesh.
13. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues i Kolegjit”)⁸ mori fillimisht në shqyrtim kërkesat e subjektit të rivlerësimit për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, riçeljen e pjesshme të hetimit gjyqësor dhe kryerjen e aktit të ekspertimit kontabël me grup ekspertësh, të parashtruara në përmbajtjen dhe në kërkimin përfundimtar të ankimit dhe të parashtrimeve të paraqitura përpara datës së zhvillimit të seancës gjyqësore. Gjithashtu, referuar provave që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur ankimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se akti i ekspertit kontabël mban datën 25.06.2019 dhe përbën një dokument të ri, të krijuar rreth 2 muaj pas shpalljes së vendimit, ndërsa dokumentet e paraqitura në dy CD përmbajnë pyetësorë, shkresa, vërtetime dhe akte të krijuara gjatë hetimit administrativ (vetë subjekti i rivlerësimit nuk referon në ankim ndonjë dokument/akt të ri të përfshirë në këtë lloj formati).
14. Trupi gjykues i Kolegjit, referuar nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, analizoi kërkesat e subjektit të rivlerësimit mbështetur në parashikimet e nenit 49 të po këtij ligji dhe të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012. Në këtë kontekst, akti i ekspertimit, bashkëlidhur ankimit, u konsiderua i panevojshëm – sipas përcaktimeve të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 – dhe nuk u pranua si provë. Së pari, subjekti i rivlerësimit ka përfshirë në një masë të gjerë konkluzionet e aktit të ekspertimit në përmbajtjen e ankimit, vlerësimi i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit sa i përket analizës financiare në tërësi dhe zërave të caktuar në veçanti, nga trupi gjykues i Kolegjit nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, është shterues dhe përmban gjithë garancitë e një analize objektive në funksion të procesit të rregullt. Së dyti, nga shqyrtimi i procedurës së ndjekur nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, bazuar në dokumentacionin e përcjellë Kolegjit, trupi gjykues konstatoi se në rastin konkret nuk gjen zbatim asnjë nga kushtet e parashikuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Konkretisht, nuk gjen zbatim germa “a” e kësaj dispozite, pasi nuk nevojitet të merren prova apo të vërtetohen fakte të reja; nuk gjen zbatim germa “b” e po kësaj dispozite pasi nuk provohet që vendimi të jetë bazuar në shkelje të rënda procedurale apo në gjendje faktike të konstatuara gabim ose në mënyrë jo të plotë; dhe c) nuk nevojitet të përsëritet marrja e disa ose të gjitha provave të marra nga Komisioni. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi të vijojë shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj

⁷ Sipas shënimeve në lajmërimarrjen e shërbimit postar, njoftimi i vendimit të Komisionit nr. {***} prot., datë 14.06.2019, është dorëzuar te subjekti i rivlerësimit më datë 17.06.2019. Ankimi mban datën 27.06.2019 dhe është regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 28.06.2019.

⁸ Përbërja përfundimtare e trupit gjykues është rezultat i shortit të datës 30.10.2020, për zëvendësimin e gjyqtarit Luan Daci, për shkak të pezullimit nga detyra me vendimin nr. 14, datë 24.07.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve, (zëvendësuar me gjyqtarin Sokol Çomo). Shih: <http://kpa.al/njoftim-380/>.

vendimit nr. 139, datë 15.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, sipas nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i pretendimeve që lidhen me interpretimin e ligjit dhe cenimin e procesit të rregullt ligjor

15. *Subjekti i rivlerësimit parashtron se e njëjta treshe gjyqtarësh që ka hetuar dhe gjykuar procesin e rivlerësimit, ka vendosur edhe shkarkimin e saj nga detyra. Analiza financiare e pasqyruar në 19 tabela, rezultatet e të cilave kanë përcaktuar edhe konkluzionin e vendimmarrjes, mbart dy “momente”: së pari, cilësia e posaçme që duhet të kenë hartuesit e këtyre tabelave nga pikëpamja e dijeve profesionale dhe metodologjia që është ndjekur dhe saktësia e shifrave për çdo zë të përzgjedhur krahasimor; dhe së dyti, vendimi ka mungesë të plotë të arsyesimit, analizës dhe deduksioneve logjike, të trajtuara gjerësisht në pjesën e ankimit që lidhet me pretendimet mbi konkluzionet e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë.*

15.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të theksojë së pari se procesi i rivlerësimit kryhet tërësisht nga institucionet e rivlerësimit, organizimi dhe funksionimi i të cilave, përfshirë edhe Komisionin, është parashikuar në ndryshimet kushtetuese e më pas është materializuar në norma të detajuara në ligjin nr. 84/2016. Ndryshimet dhe parashikimet e reja ligjore i janë nënshtruar vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ekspertizës së Komisionit të Venecias, përkatësisht në vendimet nr. 2, datë 18.01.2017 dhe nr. 78, datë 12.12.2017⁹, dhe në Opinionin CDL - AD (2016)036¹⁰. Konkretisht, në referim të opinionit të Komisionit të Venecias, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar jo vetëm frymën e ligjit nr. 84/2016 që lidhet me pajtueshmërinë me Kushtetutën të përmbajtjes së tij dhe respektimit të procesit të rregullt ligjor, por edhe kompetencat që ushtrojnë organet e rivlerësimit në kuptim të përmbajtjes dhe hapësirës ku ato shtrihen. Në vendimin nr. 2/2017, Gjykata Kushtetuese shprehet se:

[44]. Gjykata, duke bërë një interpretim sistematik të dispozitave të ligjit të kundërshtuar, nga konteksti i tyre, si dhe nisur nga kuptimi i përgjithshëm i këtij ligji, vlerëson se qëllimi i tyre është përcaktimi i rregullave që do të ndiqen gjatë procesit të rivlerësimit nga organet kushtetuese të pavarura, të cilat janë të vetmet organe që kanë kompetencën për të realizuar kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, si dhe kriteret dhe mënyra e realizimit të këtij procesi. [...] 67. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. [...].

15.2. Së dyti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, institucionet e rivlerësimit asistohen nga Njësia e Shërbimit Ligjor, strukturë që në zbatim të ligjit¹¹ përbëhet nga ekspertë me njohuri të thelluara ekonomike dhe juridike, të cilët studiojnë dosjen nga pikëpamja financiare dhe nga ajo ligjore. Kjo nënkupton që analiza financiare që hartohet nga institucionet e rivlerësimit nuk paraqet vetëm shifra dhe veprime matematikore, por edhe një

⁹ http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

¹⁰ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)036-e)

¹¹ Nenet 22 dhe 23 të ligjit nr. 84/2016 përcaktojnë veprimtarinë e Njesisë së Shërbimit Ligjor në funksion të ndihmës dhe këshillimit të institucioneve të rivlerësimit dhe kriteret që duhet të përmbushin individët që punësohen, përfshirë arsimimin dhe përvojën e punës.

vlerësim të detajuar të shpjegimeve, dokumenteve dhe të çdo lloj të dhëne të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ.

15.3. Së treti, nga shqyrtimi i arsytimit, vërehet se vendimi i Komisionit plotëson kërkesat formale të parashikuara në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, pasi vendimi është i strukturuar dhe i arsytuar, dhe përmban elementet e anës formale – pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vendimi ka mungesë të plotë të arsytimit, analizës së pretenduar dhe deduksioneve logjike përkatëse, lidhet me vlerësimin që Komisioni u ka bërë fakteve dhe provave në raport me kërkesat ligjore. Për rrjedhojë, trajtimi i mëtejshëm i kësaj çështjeje është elaboruar në analizën e shkaqeve të ankimit që lidhen me themelin e çështjes mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë.

15.4. Kuadri ligjor që normon procesin e rivlerësimit, dikton që ushtrimi i funksioneve nga institucionet e rivlerësimit të bëhet mbi bazën e pavarësisë, paanësisë, barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në asnjë nga pretendimet e shtjelluara nga subjekti, siç arsyetohet edhe në vijim, nuk rezulton të jenë shkelur këto parime.

16. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, pretendon se hetimi administrativ është i njëanshëm dhe i realizuar në kundërshtim me normat procedurale dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, mosrespektimi i të cilave ka sjellë dhënien e një vendimi të gabuar.* Sipas saj, Komisioni nuk ka respektuar parimin e ligjshmërisë, parimin e drejtësisë dhe paanësisë, parimin e barazisë para ligjit, parimin e mbrojtjes juridike të të drejtave dhe lirive kushtetuese të individit, parimin e proporcionalitetit, parimin e kontradiktorialitetit, parimin e barazisë së armëve, parimin e gjykimit të provave dhe fakteve në mënyrë të paanshme, parimin e dhënies së një vendimi të bazuar në prova dhe në ligj. Këto argumente mbështeten në analizën e dispozitave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në rekomandimin CM/Rec (2010/12) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, në nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 49/2012. Sipas subjektit të rivlerësimit, moszbatimi i këtyre parimeve sjell cenim të procesit të rregull ligjor, trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj në vendimet: nr. 79/2017, paragrafët 25 – 28, nr. 37/2016, paragrafët 11 - 14 dhe nr. 49/2016 dhe në praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNJ”).

16.1. Nga shqyrtimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vëren se hetimi administrativ në kuadër të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit është zhvilluar përgjatë një periudhe mbi 1- (një-) vjeçare (24.01.2018¹² – 07.03.2019¹³). Përgjatë kësaj periudhe, Komisioni ka mbledhur dhe analizuar informacione nga institucionet qendrore dhe vendore, publike dhe private për subjektin e rivlerësimit për të tria kriteret e rivlerësimit. Po ashtu, Komisioni ka pasur komunikim intensiv me subjektin e rivlerësimit për shkëmbim informacioni dhe ka administruar dokumentacionin provues të përcjellë prej saj. Kronologjia dhe përmbajtja e komunikimeve ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit përgjatë periudhës 09.02.2018¹⁴ – 11.04.2019¹⁵, dëshmon se subjekti i rivlerësimit është pyetur, i është dhënë e drejta të njohë aktet¹⁶, ka dhënë shpjegime dhe ka përcjellë dokumente dhe akte në cilësinë e provave, është ftuar për t’u dëgjuar në seancë

¹² Vendimi nr. {***}, datë 24.01.2018.

¹³ Vendimi nr. {***}, datë 07.03.2019, “Për mbylljen e hetimit administrativ për tri kriteret, për subjektin e rivlerësimit, znj. Albina Spaha”.

¹⁴ Përgjigjet e pyetësorit standard, regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 09.02.2018.

¹⁵ Data e zhvillimit të seancës dëgjimore në Komision.

¹⁶ Më datë 13.03.2019, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar deklaratën për njohjen me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike të dosjes së hetimit administrativ dhe marrjes së tyre në CD, sipas kërkesës së saj.

dëgjimore¹⁷, ka marrë pjesë dhe ka parashtruar qëndrimin e saj mbi gjetjet e hetimit të Komisionit, si dhe ka diskutuar me anëtarët e trupit gjykues dhe me vëzhguesen ndërkombëtare gjatë seancës dëgjimore. Po kështu, nga analiza e shkëmbimeve shkresore mes saj dhe Komisionit dhe e procesverbalit të seancës dëgjimore, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë parashtruar pretendime për shkelje të të drejtave të garantuara në ligj për procesin e rregullt ndaj saj gjatë rivlerësimit në Komision, apo të ketë parashtruar kërkesa specifike që tregojnë apo pretendojnë njëanshmëri apo mosrespektim të parimeve për një proces të rregullt ligjor gjatë hetimit.

16.2. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar në fashikujt e Komisionit, rezulton se të tre anëtarët e trupit gjykues të Komisionit kanë deklaruar se nuk gjenden në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Për më tepër, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur kërkesa apo pretendime për konflikt të mundshëm interesi me anëtarët e trupit gjykues, gjë e cila mund të vinte në dyshim paanësinë e gjykimit apo të cenimit të mundshëm të procesit të rregullt ligjor. Në përmbledhje të këtyre elementeve, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjektin të rivlerësimit i janë respektuar të gjitha të drejtat për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

16.3. Nga përmbajtja e vendimit konstatohet se Komisioni u është referuar të dhënave të dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit, ka cituar deklaratimet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, dhe ka parashtruar arsyetimin ligjor dhe vlerësimin nëpërmjet konkluzioneve të pasqyruara për secilën gjetje. Në vlerësimin e Komisionit, është krijuar bindja se për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pamjaftueshëm. Ndërsa, për kriterin e kontrollit të figurës dhe për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në vlerësimin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar e përshtatshme dhe e pranueshme për vazhdimin e detyrës. Vlerësimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë është rezultat i interpretimit të trupit gjykues të dispozitave ligjore përkatëse në rrethanat e faktit dhe jo pasojë e moskonsiderimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej saj. Edhe kuadri ligjor në të cilin Komisioni është mbështetur për interpretimin e fakteve dhe konkluzionet e vlerësimit, është cituar shprehimisht në tekstin e vendimit, çka përjashton pretendimin se Komisioni nuk ka respektuar parimin e ligjshmërisë. Vendimi i dhënë për shkarkimin nga detyra është proporcional në raport me rezultatin përfundimtar të procesit për deklaratim të pamjaftueshëm në kriterin e pasurisë dhe mungesës së burimeve financiare për të justifikuar pasurinë, duke qenë brenda rekuizitave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

16.4. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të sa është shtjelluar më sipër, vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për proces jo të rregullt ligjor, për shkak të moszbatimit të parimeve të ligjshmërisë, drejtësisë dhe paanësisë, barazisë para ligjit, mbrojtjes juridike të të drejtave dhe lirive kushtetuese të individit, proporcionalitetit, kontradiktorialitetit dhe barazisë së armëve është i pambështetur në fakte dhe në prova. Pretendimi mbi zbatimin e gabuar të normave materiale është trajtuar gjerësisht në analizën e shkaqeve të ankimit që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë.

- 17.** *Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është i njëanshëm, i pabazuar në provat e depozituara gjatë procesit, i pabazuar në një analizë të saktë financiare, i pabazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 17, 30, 31, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me mungesë të argumentimit dhe analizës juridike të fakteve dhe rrethanave konkrete.*

¹⁷ Me vendimin "Për kalimin në seancë dëgjimore të subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha" nr. {***}, datë 04.04.2019. Ftesa për t'u dëgjuar mban datën 05.04.2019.

Subjekti i rivlerësimit e mbështet argumentimin në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 3/2015.

17.1. Trupi gjykues i Kolegjit, përpos sa është shtjelluar më sipër, vëren se subjekti i rivlerësimit përgjatë procesit të rivlerësimit të kryer në Komision, ka paraqitur një sërë dokumentesh për të shoqëruar shpjegimet dhe informacionin e dhënë lidhur me pyetjet, çështjet e evidentuara për qartësim si edhe në përgjigje të barrës së provës. Shpjegimet e saj kanë gjetur pasqyrim edhe në tekstin e vendimit. Vetë subjekti i rivlerësimit, në parashtrimin e këtij pretendimi, nuk ilustron në çfarë mënyre dhe mbi bazën e çfarë motivi, vendimmarrja e Komisionit është e njëanshme. Ky pretendim, që gjendet i pabazuar, është trajtuar më gjerësisht edhe në paragrafët vijues të vendimit, ku trajtohen pretendimet që lidhen me analizën financiare dhe me çështjet e tjera të kriterit të vlerësimit të pasurisë.

18. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, pretendon se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 të KEDNj-së pasi nuk ka analizuar dispozitat ligjore procedurale dhe materiale, ka marrë një vendim të paarsyetuar, me mungesë përfundimesh logjike, duke cenuar rëndë procesin e rregullt ligjor dhe të drejtat e subjektit të rivlerësimit dhe se vendimi ka shkelur nenin 57 të ligjit nr. 84/2016.* Përmbajtja e vendimit nuk ka karakter analitik, interpretues të të dhënave dhe arsytim, vijon subjekti. Tabelat e referuara në vendimmarrje duhet të tregonin metodologjinë e ndjekur, logjikën e përdorur dhe më pas të arsyetohej dhe të konkludohej. Kjo qasje, sipas saj, e ka bërë të nevojshme të kryhet një akt ekspertimi në këtë fazë dhe kërkon riçeljen e hetimit gjyqësor dhe urdhërimin e kryerjes së ekspertimit kontabël nga Kolegji, me grup ekspertësh. Domosdoshmëria e hartimit të këtij akti ka lindur për shkak të problemeve me formën dhe përmbajtjen e vendimit dhe mungesën e arsytimit mbi qëndrimet e saj. Subjekti i rivlerësimit ka angazhuar një ekspert kontabël, raporti i të cilit i është bashkëngjitur ankimit. Ekspertit i është kërkuar të shprehet për çështjet në vijim.

- *Saktësinë e tabelave analitike të renditura në vendim e, mbi këtë bazë, shqyrtimin e vërtetësisë së tyre, mbi bazën e gjithë dokumentacionit.*
- *Nëse kjo vërtetësi/saktësi është e munguar, ndërtimin e tabelave analizuese, korrigjuese të sa KPK rendit.*
- *Konsiderimin e drejtësisë së logjikës së ndjekur nga KPK-ja në çdo veprim të karakterit matematikor të renditur ndër faqet e vendimit, krahasuar me burimet konkrete që u referohet KPK-ja, përkatësisht të dhënat e INSTAT-it, treguesit statistikorë të anketës së matjes së nivelit të jetesës dhe/ose buxhetit të familjes, etj.*
- *Saktësinë e renditjes së zërave, mundësinë e mosshënimit të ndonjë të dhënë apo dublimit përkatës, si dhe shumatores.*

18.1. Nga shqyrtimi i akteve të administruara, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në rezultatet e hetimit administrativ¹⁸, Komisioni shprehet se për periudhën 2005 – 2016¹⁹ (periudhë e deklarimeve të gjendjeve *cash*), subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me balancë negative në vlerën 6.313.597 lekë për periudhën 2005 – 2010 dhe 2012 – 2015. Për vitet 2011 dhe 2016, gjendja financiare në datën 31 dhjetor rezulton me balancë pozitive. Në këtë vlerësim, Komisioni shpjegon se ka arritur duke marrë në konsideratë të ardhurat e vërtetuara të familjes S., shpenzimet për transport të deklaruara, shpenzimet jetike referuar raportit të ILDKPKI-së, vlerat monetare në bankë referuar dokumentacionit përkatës, si dhe vlerat monetare *cash*, shtesa/pakësime dhe gjendje në banesë në fillim dhe në fund të periudhës, sipas deklarimeve dhe shpjegimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorëve. Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për konstatimin e balancës negative. Në

¹⁸ Përcjellë subjektit të rivlerësimit në rrugë elektronike më datë 11.03.2019, konfirmuar marrja më datë 12.03.2019.

¹⁹ Shih faqet 28 – 29.

përgjigje të saj²⁰, subjekti i rivlerësimit ka dhënë argumente dhe prova për të kundërshtuar balancat negative për vitet 2005 – 2007 dhe 2013 – 2015 dhe është shprehur se për analizën financiare për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2012, Komisioni nuk i ka dhënë sqarime me tabela, sikurse është vepruar për vitet e tjera, në mënyrë që të mund ta krahasonte me të dhënat e saj dhe të paraqiste provat dhe argumentet përkatëse²¹. Në vijim të këtij parashtrimi, në datën 02.04.2019, Komisioni i ka dërguar subjektit të rivlerësimit në rrugë elektronike një tabelë në formatin *Excel*, me informacionin e detajuar në lidhje me përllogaritjet e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të nesërmen, më 03.04.2019, subjekti i rivlerësimit ka kthyer përgjigje duke konstatuar, që pas njohjes me tabelat, ka vënë re që pagat e bashkëshortit janë përllogaritur jo sipas deklarimeve dhe vërtetimeve, por sipas verifikimeve – sa i përket analizës financiare të viteve 2008, 2009, 2010 dhe 2012. Subjekti ka parashtruar po ashtu që nëse reflektohen ndryshimet për të marrë në konsideratë të ardhurat sipas vërtetimeve të punëdhënësve, balanca e fondeve rezulton pozitive për secilin vit. Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një tabelë që reflektonte ndryshimet e kërkuara prej saj.

18.2. Nga procesverbali i seancës dëgjimore, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, nuk ka parashtruar pyetje apo shqetësime lidhur me metodologjinë e përllogaritjes së vlerave në analizën financiare, duke u shprehur qartë se edhe Komisioni, sikurse edhe vetë ajo, u ishin referuar të dhënave të publikuara nga INSTAT-i. Po ashtu, nuk rezulton që subjekti të ketë ngritur kërkesë as për sa i përket kryerjes së aktit të ekspertimit kontabël, ndonëse ishte në dijeni të pasqyrave financiare të hartuara nga Komisioni. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit, vërehet se në analizën financiare për periudhën 2005 – 2016, përpos elementeve të cituara në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka marrë në konsideratë kërkesën e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të transportit dhe atyre të karburantit të deklaruara, duke konkluduar me një balancë negative në vlerën 5.896.320 lekë²². Nga ana tjetër, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në ankim janë kontradiktore në vetvete. Konkretisht, ndërsa nga njëra anë subjekti i referohet analizës financiare në format *Excel* të përcjellë nga Komisioni me *e-mail* [më datë 02.04.2019, faqe 22 e ankimit dhe faqe 19 e parashtrësive të datës 04.01.2021, analiza e gjetjeve të ekspertit kontabël], nga ana tjetër, ajo pretendon se Komisioni nuk i ka dhënë analizë financiare për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2012 [faqe 39 e ankimit dhe faqe 35 e parashtrësive të datës 04.01.2021]. Ndërkohë që nga tabela në format *Excel* [e administruar në dosjet e Komisionit], rezulton se në të janë pasqyruar të dhëna mbi pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet, për periudhën përpara deklaramit dhe për periudhën 2003 – 2016 (përfshirë edhe vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2012²³), dhe një analizë gjithëpërfshirëse të viteve 2003 – 2016, shoqëruar me shënime sqaruese²⁴.

18.3. Në vijim edhe të arsytimit të shprehur më sipër dhe më tej (në paragrafin 23.1 të këtij vendimi), trupi gjykues nuk konstaton rrethana që cenojnë procesin e rregullt ligjor, apo shkelin të drejtat e subjektit të rivlerësimit lidhur me pasjen e një vendimi të arsyetuar, si në aspektin formal ashtu edhe në atë përmbajtësor. Gjatë procesit të zhvilluar, Komisioni i ka garantuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t'u mbrojtur. Përpos kësaj, vendimi është i arsyetuar dhe pasqyron gjetjet e Komisionit dhe aktet mbi të cilat ato mbështeten, qëndrimin

²⁰ Përcjellë në rrugë elektronike më datë 28.03.2019.

²¹ Shih faqet 26 – 27.

²² Shih faqen 29 të vendimit.

²³ *Fashikulli 15, faqe 2148 – ku pasqyrohen të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit sipas deklaratave të interesave privatë për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2012, përkatësisht: 1.500.000 lekë, 1.600.000 lekë, 1.800.000 lekë dhe 1.800.000 lekë.*

²⁴ *Shënime, si: “nga qiraja”; “shkresa nr. {***} dhe {***} prot., datë 21.12.2018 nga T.O. dhe përgjigje pyetësorit të fundit”; “përgjigje të pyetësorit 15.01.2019”; “sipas shpenzimeve minimale për konsum ILDKPKI me shkresë nr. {***} prot., datë 29.01.2019”.*

e subjektit dhe vlerësimin për çdo gjetje, duke përfunduar edhe me vlerësimin e përgjithshëm. Ky pasqyrim i fakteve, provave dhe bazës ligjore i ka dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të paraqesë argumentet e saj për të kundërshtuar vlerësimin e kryer nga Komisioni. Sa më sipër, është në përputhje edhe me jurisprudencën e GjEDNj-së (*Hirvisaari kundër Finlandës, § 30 deri në fund*)²⁵ sipas së cilës, ndër të tjera: [...] është i arsyetuar në mënyrë të vlefshme një vendim, i cili u lejon palëve të përdorin realisht të drejtën e tyre për apelim [...], dhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, pasqyruar në vendimin nr. 3/2015:

*[...] Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (shih vendimet nr. 8, datë 28.02.2012; nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 25, datë 10.06.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*²⁶.

19. Siç shtjellohet edhe në paragrafin 15 [dhe nënparagrafët e tij] të këtij vendimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet dhe të dhënat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfshirë analizën financiare në formë tabelare dhe shpjegimet mbi analizën financiare të pasqyruar në përmbajtjen e ankimit, i janë nënshtruar vlerësimit nga Kolegji, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se edhe kërkesa e subjektit të rivlerësimit për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe urdhërimin e kryerjes së ekspertimit kontabël me grup ekspertësh, është e pabazuar.
20. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, parashtron se shkarkimi i saj nga detyra është vendosur në kundërshtim me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk është vërtetuar ndonjë prej rasteve të parashikuara nga kjo dispozitë. Që të vendoset kjo masë, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative disa kritere që lidhen me vlerësimin e pasurisë, integritetin dhe/ose profesionalizmin. Më tej, subjekti argumenton që deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë përbën sjelljen më të rëndë, e cila duhet të referojë në njërën nga situatat e përcaktuara në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe do të duhet të ishte në të njëjtin nivel kundërligjshmërie, si edhe rastet e renditura në pikat 1, 2, 4 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit të rivlerësimit, mungesa e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, referuar nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 mund të përbëjë deklarim të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3, vetëm nëse shkelja është në nivel të krahasueshëm ose të njëjtë me fshehjen e pasurisë, deklarimin e rremë ose situatën e konfliktit të interesit – parashikuar respektivisht nga gerrat “c”, “ç” dhe “d” të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

20.1. Lidhur me këtë interpretim të kuptimit dhe zbatimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur edhe në jurisprudencën e konsoliduar tashmë²⁷, sjell në vëmendje se nga leximi harmonik i kësaj dispozite me nenin 33 [të po këtij ligji], deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë përbën një zbatim në nivelin e ligjit të përcaktimeve kushtetuese të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Nga ana tjetër, deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, rregullohet në një nen

²⁵ Shih: https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_SOI.pdf (paragrafi 237).

²⁶ Shih paragrafin 16 të vendimit nr. 3, datë 26.01.2015, të Gjykatës Kushtetuese, në: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

²⁷ Shih vendimin nr. 19/2019: http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh_Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralel.pdf.

të dedikuar të Aneksit të Kushtetutës, nenit Dh. Pavarësisht se të dyja këto elemente janë përmbledhur në normimin ligjor të pikës 3 të nenit 61, për shkak të drejtimit të qartë që jep Aneksi i Kushtetutës, për këto dy kritere – deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës – nuk mund të argumentohet se duhet të interpretohen në mënyrë kumulative. Me fjalë të tjera, këto kritere nuk kërkojnë doemos praninë e njëra-tjetrës për t'u vërtetuar deklarimi i pamjaftueshëm.

20.2. Kjo qasje përputhet edhe me dispozitat e ligjit nr. 84/2016 që rregullojnë kriteret e vlerësimit më vete. Konkretisht, procesi i vlerësimit të kriterit të pasurisë zërthehet në nenin 30 – 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë parimet dhe mënyrën e verifikimit të përmbushjes së detyrimeve të subjektit të rivlerësimit për të kryer deklarim të saktë, për të provuar burimet e mjaftueshme financiare të ligjshme dhe mungesën e konfliktit të interesit. Përpos kësaj, nga përmbajtja e nenit 61 në të pestë paragrafët e tij, del në pah që legjislatori ka zgjedhur formulimin alternativ, duke u dhënë të njëjtën peshë shkeljeve për shkaqe të veçanta. Vërtetimi i secilit prej këtyre shkaqeve autonome shkon në favor të prezumimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Kjo do të thotë se subjektet e rivlerësimit duhet të shpjegojnë bindshëm se nuk gjenden në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme, nuk kanë kontakte të papërshtatshme, nuk kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm të vlerësimit të pasurisë, nuk kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm të kontrollit të figurës, janë të aftë profesionalisht, dhe që me sjelljet dhe veprimet e tyre nuk kanë cenuar besimin e publikut të drejtësia.

20.3. Në funksion të qëllimit të procesit të rivlerësimit, në mënyrë që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi, duhet të përjashtohet ekzistenca e rrethanave që asociohen me secilin kriter të rivlerësimit, individualisht për subjektet e rivlerësimit që zgjedhin të qëndrojnë në detyrë. Nga ana tjetër, nëse ndiqet interpretimi i subjektit të rivlerësimit, do të duhet të qëndronin në sistemin e drejtësisë subjekte të cilat ruajnë dhe i deklarojnë me saktësi lidhjet e tyre *me krimin e organizuar*, për sa kohë nga kontrolli i pasurisë rezultonin *pa* probleme. Po ashtu, do të qëndronin në sistemin e drejtësisë subjekte me pasuri *përtej* çfarë mund të justifikohet me burime të ligjshme [përfshirë edhe fshehje, deklarim të rremë, deklarim të pamjaftueshëm apo konflikt interesi], për sa kohë *nuk kanë* krijuar lidhje *me krimin e organizuar*. Si rrjedhojë, qëndrimi i mëtejshëm në drejtësi do të mundësohej për cilindo magistrat me probleme të konfirmuara pasurie të pajustificuar me burime të ligjshme, ose me kontakte me krimin e organizuar, për sa kohë zbatohet vetëm njëra rrethanë. Kjo alternativë teorike, dukshëm bie ndesh me arsyet për të cilat u ngrit rivlerësimi kalimtar. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit dhe interpretimi kumulativ mbi të cilin mbështetet ky shkak ankimi, është i pabazuar pasi bie ndesh jo vetëm me gjuhën e dispozitave që rregullojnë deklarimin e pamjaftueshëm në Kushtetutë dhe ligj, por edhe me frymën e procesit të rivlerësimit.

- 21.** *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka mbajtur në vendime të ndryshme standarde të ndryshme kuptimi dhe vlerësimi për qëllimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke cenuar parimin e barazisë para ligjit të subjekteve të rivlerësimit.* Subjekti i rivlerësimit argumenton se nuk ka kryer shkelje të rëndë në raport me deklarimin e pasurisë, por ka deklaruar me saktësi vlerat e të ardhurave të siguruar nga burime të ligjshme.

21.1. Trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje, se ekzistenca dhe kompetencat që i janë rezervuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit për bërë garancinë institucionale të krijuar nga ligjvënësi për të shëruar çdo cedim të mundshëm nga Komisioni. Kjo garanci adreson dhe rëndësinë e nënvizuar nga jurisprudenca e GjEDNj-së për krijimin e mekanizmave që mund

të sigurojnë koherencën e praktikës dhe njësimin e jurisprudencës²⁸, e cila do t'i shërbejë Komisionit për të mbajtur qëndrime konsistente në interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit të rivlerësimit, mbi bazën e provave dhe rrethanave të çdo çështjeje konkrete²⁹. Në këtë kontekst, pretendimet, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit iu nënshtuan vlerësimit nga ana e Kolegjit, referuar shkaqeve të ankimit lidhur me themelin, duke qenë objekt i këtij vendimi dhe duke gjetur pasqyrim në paragrafët vijues të këtij vendimi.

21.2. Për sa i përket pretendimit të subjektit se ka deklaruar saktësisht dhe nuk ka kryer shkelje të rëndë, në vijim edhe të arsyetimit më sipër mbi ligjshmërinë e burimeve të të ardhurave, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që barrën e provës për të shpjeguar bindshëm deklaratimet, të ardhurat e pretenduara, si dhe përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë edhe interesat privatë të personave të lidhur, e kanë subjektet e rivlerësimit³⁰. Në këtë kontekst, kuptimi dhe zbatimi i nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe i dispozitave të ligjit nr. 84/2016 duhet të jetë i njëjtë për të gjitha subjektet e rivlerësimit. Po kështu, vlerësimi i subjekteve të rivlerësimit që kanë kryer të njëjtat shkelje, në kontekstin e parimit të barazisë para ligjit dhe në ligj, duhet të mbështetet në specifikat dhe rrethanat që kanë sjellë shkeljen e kryer, duke shmangur vlerësime të ndryshme për të njëjtat specifika dhe rrethana. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit mban në konsideratë qëndrimin e shprehur nga Gjykata Kushtetuese, si dhe GjEDNj-ja:

[...] Barazia në ligj dhe para ligjit nuk duhet kuptuar se për çështje gjyqësore të pretenduara identike, të ketë zgjidhje të njëjtoja nga gjykatat. Mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, sepse çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, e harmonizuar me rrethana, faktorë, motive apo prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë absolutisht të njëjtoja. [...] Barazia në ligj dhe para ligjit nuk ka të bëjë me mënyrën se si është zgjidhur çështja në themel, por me garancitë ligjore, me të drejtat që shteti ka vënë në dispozicion të qytetarëve të tij për zgjidhjen e problemeve të tyre. [...]»³¹.

[...] një diferencë në trajtimin e personave në situata të ngjashme [...]. Një trajtim i diferencuar është diskriminues nëse nuk ka objektiv dhe arsye të përligjur; me fjalë të tjera, nëse nuk ndjek një synim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjetit të përdorur dhe synimit të kërkuar për t'u përmbushur [...]»³².

21.3. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, nuk ilustron arsyet për të cilat vendimi i Komisionit në lidhje me rivlerësimin e saj e ka vendosur në kushtet e pabarazisë përpara ligjit apo bazën mbi të cilën ajo është diskriminuar, ky vlerësim i Kolegjit mbetet në nivel parimor. Në këtë kontekst, trupi gjykues i Kolegjit thekson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për njësim të standardeve adresohet nëpërmjet këtij shqyrtimi nga Kolegji, i cili

²⁸ Shih Beian k. Romania (no. 1), §§ 37 dhe 39; Lupeni Greek Catholic Parish and Others k. Romania [GC], §§ 116-35).

²⁹ Shih vendimin nr. 71, datë 02.12.1998, të Gjykatës Kushtetuese: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

³⁰ Përcaktuar nga neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe zbatimin e parimeve të tij ndër të tjera në nenin 52, pika 2 dhe 32 të ligjit nr. 84/2016.

³¹ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 71, datë 02.12.1998: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

³² Shih Burden k. Mbretërisë së Bashkuar (29.04.2008), paragrafi 60: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%5B%22burden%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-86146%22%5D%7D>.

korrigjon gabimet procedurale të kryera nga Komisioni³³ dhe jep orientime për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme³⁴. Në këto kushte, ky pretendim i subjektit prezumohet i ezauruar nëpërmjet kontrollit të kryer në Kolegj, të pasqyruar në këtë vendim.

22. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit ka mungesë kohezioni, pasi nga njëra anë vlerësohet se ka pasuri të cilat nuk provohen të jenë krijuar me ardhura të ligjshme, dhe nga ana tjetër raportet konfidenciale të institucioneve janë pozitive.* Sipas subjektit të rivlerësimit, mosvlerësimi i raporteve pozitive të shërbimeve të inteligjencës dhe të aftësive profesionale sjell shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë. Sipas subjektit të rivlerësimit, konkluzioni i Komisionit lidhur me pasurinë nuk qëndron në raport me figurën, moralin dhe aftësitë profesionale.

22.1. Trupi gjykues i Kolegjit së pari sjell në vëmendje sa është shtjelluar më sipër në nënparagrafët 20.1 - 20.3 në lidhje me gjuhën dhe frymën e procesit të kontrollit të pasurisë dhe atij të figurës, si dy kritere të pavarura nga njëra-tjetra. Së dyti, pa hyrë në përsëritje të sa më sipër mbi arsyet për të cilat interpretimi i propozuar nga subjekti do të ishte alogjik – meqenëse do të passillte qëndrimin më tej në drejtësi të magjistratëve me pasuri të pajustificuara, por të cilët rezultonin të përshtatshëm në kontrollin e kriterit të figurës – trupi gjykues vëren që masa disiplinore për subjektin ka qenë pasojë e prezumimit ligjor për masë *disiplinore* të shkarkimit. Kjo masë është zbatim i drejtpërdrejtë i pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Koncepti i prezumimit të pafajësisë, një parim themelor ngushtësisht penal, nuk mund të argumentohet se gjen vend në procesin e rivlerësimit. Procesi i rivlerësimit është me natyrë administrative dhe barra e provës në këtë proces u përket subjekteve të rivlerësimit³⁵. Më tej, pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, qartazi përcakton detyrimin e subjekteve të rivlerësimit që të *shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave*. Leximi i thjeshtë [i pathelluar] i kësaj dispozite dhe i atyre të ligjit përjashton çdo debat mbi rëndësinë që ka deklarimi i saktë i pasurive në kuadër të vlerësimit të këtij kriteri. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha, se konkluzioni i Komisionit duhet të ishte mbështetur te figura, “moral” dhe aftësitë profesionale të saj, duket se bazohet mbi një interpretim tejet individual, sipas të cilit kriteri i pasurisë kushtëzohet nga ai i figurës, që nuk rezulton nga shkronja e ligjit. Përkundrazi, neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se për t’u konfirmuar në detyrë, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative vlerësimet pozitive në të tria kriteret së bashku: nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel i besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Si i tillë, edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar.

22.2. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit thekson edhe që, sipas dispozitave të parashikuara nga nenet 45, 50, 52 dhe 57 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit kanë tagrin e plotë dhe pavarësinë të hetojnë dhe të vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, të kërkojnë informacion dhe të bashkëpunojnë me organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, për të verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit, t’i kalojnë barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën e gjetjeve dhe, në përfundim, të nxjerrin vendim të arsyetuar me shkrim mbi vlerësimin dhe konkluzionet e shqyrtimit të çështjes. Ky interpretim është konfirmuar nga jurisprudenca e Kolegjit dhe vjen si rrjedhojë edhe e qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese dhe Opinionit të Komisionit të Venecias, të cilët kanë konfirmuar që procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve kryhet nga organet e rivlerësimit me ndihmën e organeve të tjera shtetërore ekzistuese, të cilat [...] do të ndihmojnë organet e rivlerësimit në

³³ Neni F, pika 3, fjalia e parë e Aneksit të Kushtetutës.

³⁴ Neni 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

³⁵ Shih edhe paragrafin 21.2 dhe poshtëshënimin nr. 30.

*ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese dhe përmbushjen e misionit të tyre [...]*³⁶. Në përfundim të këtij arsyetimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur në ligj.

23. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se trupi gjykues i Komisionit nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, si element thelbësor i procesit të rregullt ligjor, duke iu referuar vendimit të GjEDNj-së Belilos kundër Zvicrës. Sipas subjektit të rivlerësimit, hetimi, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit nga e njëjta trupë gjykuese, e cila heton faktet dhe jep vendim në lidhje me gjetjet e bëra nga vetë ajo, pra është edhe “organ akuzator” dhe “gjykatë”, cenon parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme.*

23.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit i referohet mënyrës së konceptimit të sistemit të rivlerësimit, në kontekstin kushtetues dhe atë ligjor të miratuara me ligjet nr. 76/2016 dhe nr. 84/2016, dhe jo veprimeve konkrete të Komisionit që lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit thekson qëndrimin e shprehur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017³⁷ dhe në opinionin e Komisionit të Venecias³⁸, se organet e procesit të rivlerësimit ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për zhvillimin dhe respektimin e një procesi të rregullt ligjor. Po kështu, në kushtet kur vendimi i Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit të hollësishëm nga ana e Kolegjit, garancitë për një proces të rregullt ligjor dhe për një gjykim efektiv dhe të paanshëm materializohen nga kontrolli që ushtron Kolegji, duke adresuar në këtë mënyrë edhe parimet e trajtuara në praktikën e GjEDNj-së, të sjella në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit, në çështjen *Belilos kundër Zvicrës*³⁹. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur në ligj.

24. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, pretendon se sjellja e saj në deklarinë e pasurive dhe të ardhurave të saj dhe të personit të lidhur nuk mund të klasifikohet sjellje e rëndë dhe e qëllimshme e që cenon besimin e publikut te funksionarët e drejtësisë e të përligjë shkarkimin nga detyra sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Besueshmëria lidhur me ligjshmërinë e krijimit të pasurisë duhet të bazohet mbi fakte, prova, rrethana objektive dhe sjellje të subjektit e parashikimet e ligjit, vlerësuar në tërësi në mënyrë objektive, në proporcionalitet, duke mbajtur të njëjtin standard, në respektim të parimit të barazisë ligjore. Në ankim, subjekti i referohet vendimit të Komisionit nr. 51, datë 25.07.2018, duke cituar një pjesë të vendimit në të cilën arsyetohet se vërtetësia e deklarimeve është dytësore krahasuar me sjelljen e subjekteve.*

24.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky shkak ankimi, si edhe disa të trajtuar më sipër, përbëjnë një interpretim që përzien pjesë autonome të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, e konkretisht, pikat 3 dhe 5. Pa përsëritur sa është shtjelluar me herët në paragrafin 20 [dhe nënparagrafët e tij], deklarimi i pamjaftueshëm – neni 61, pika 3 – është veçmas dhe përbën në vetvete shkak autonom për zbatimin e prezumimit të zbatimit të masës disiplinore. Cenimi i besimit të publikut përbën një shkak tjetër, të pavarur nga konstatimi i deklarinë të pamjaftueshëm. Po ashtu, dispozitat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë përgjegjësitë për deklarinë të saktë nuk parashikojnë që mjaftueshmëria dhe saktësia duhet të analizojnë qëllimet e subjekteve. Konkretisht, neni D, pika 5 e kushtëzon prezumimin në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe detyrimin për subjektin të provojë të kundërtën si pasojë e përpjekjes për të paraqitur në mënyrë të “pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në

³⁶ Shih paragrafin 44 të vendimit nr. 2/2017 në: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

³⁷ http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

³⁸ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

³⁹ Shih edhe vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Ç. Shahini [JR nr. 26/2020], paragrafi 20.2.

përdorim”. Nga analiza e vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, rezulton që zbatimi i nenit 61, pika 3 për subjektin e rivlerësimit, znj. Albina Spaha, ka ardhur si pasojë e gjetjeve nga *dokumentacioni* që dëshmojnë mungesë të deklaramit të saj të posedimit të apartamentit në kohën kur ky fakt ka ndodhur, dhe që në analizë të *dokumentacionit*, subjekti ka pasur mungesë burimesh të ligjshme për të kryer shpenzimet dhe krijuar pasuritë në momentin kur këto janë krijuar. Masa disiplinore e dhënë është pasojë e parashikimit në ligj të prezumimit të shkarkimit, për sa kohë subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën.

24.2. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vendimi të cilit subjekti i referohet, nuk i është nënshtruar kontrollit të Kolegjit. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues çmon të theksojë se Kushtetuta dhe ligji⁴⁰ kanë përcaktuar detyrimin e subjekteve të shpjegojnë *bindshëm burimin e ligjshëm* të pasurive dhe të ardhurave dhe të paraqesin *dokumentacion* që justifikon vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit; pamundësia e paraqitjes së dokumentacionit duhet të provohet. Këto parashikime ligjore zërthehen në detaj edhe në udhëzimin nr. 4095/2016 të inspektorit të ILDKPKI-së, i cili në mënyrë të shprehur përcakton detyrimin për të shoqëruar çdo zë të deklaruar me dokumentacion ligjor. Në dritë të sa më sipër, me jurisprudencën e tij, Kolegji tashmë ka mbajtur qëndrim sa i përket rëndësisë së dokumentacionit në provueshmërinë e deklarimeve nga subjektet në funksion të procesit të rivlerësimit⁴¹. Për këto arsye, vlerësimi nëse Komisioni ka respektuar drejt parimin e barazisë përpara ligjit për subjektin e rivlerësimit, krahasuar me subjekte të tjera, konsiderohet i shteruar nëpërmjet shqyrtimit të ankimit të subjektit të rivlerësimit. Në konkluzion, duke pasur në vëmendje edhe arsyetimin në paragrafin 21 [dhe nënparagrafët e tij] të këtij vendimi, ky shkak ankimi i subjektit mbetet i pambështetur.

25. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka zbatuar gabim nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke cenuar qëllimin e ligjit në tërësi dhe të vetë Kushtetutës, të cilat nuk synojnë të largojnë nga sistemi i drejtësisë personat që mund të kenë pasaktësi në deklarime dhe që nuk kanë indicie për përfshirje të tyre në veprimtari të paligjshme apo të papajtueshme me detyrën.*

25.1. Pa përsëritur arsyetimin e detajuar në paragrafët 20.1 - 20.3 dhe 22.1 më sipër, sa i përket dinamikës së pavarur ndërmjet tyre të tri kritereve të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit, së pari rithekson që dispozitat kushtetuese dhe ligjore – konkretisht neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 33, pika 5, germa “a”, si dhe 61, pika 3 – diktojnë masën e shkarkimit kur vërtetohet përpjekje për deklarim të pasaktë nga subjektet. Së dyti, në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha, konkluzioni i Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm ka qenë si pasojë e gjetjes së mungesës së burimeve të ligjshme, përpos pasaktësive në deklarim. Së fundmi, përfshirja në veprimtari të paligjshme apo të papajtueshme me detyrën, është shkak autonom për vlerësim nga organet e rivlerësimit, pavarësisht nëse bashkekziston me deklarime të pasakta. Edhe ky pretendim rezulton të jetë një interpretim individual nga subjekti i pjesëve të ndryshme të dispozitave të mëvetshme të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i pambështetur në gjuhën apo frymën e ligjit. Në kontekst të qëllimit të procesit të rivlerësimit, i cili synon funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe kthimin e besimit të publikut te drejtësia, dështimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha, për të justifikuar bindshëm krijimin e pasurisë dhe të ardhurat

⁴⁰ Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 32 i ligjit nr. 84/2016, pikat 1 dhe 2.

⁴¹ Shih, ndër të tjera, vendimet e Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. A. Xhoxhaj [JR nr. 09/2018 – paragrafi 84], subjektit të rivlerësimit E. Sadiku [JR 07/2019 – paragrafi 22], subjektit të rivlerësimit, znj. A. Brati [JR nr. 14/2019 – paragrafi 24.3], subjektit të rivlerësimit Xh. Zaganjori [JR nr. 19/2019 – paragrafi 31], subjektit të rivlerësimit A. Kosova [JR nr. 5/2020 – paragrafi 41.4], subjektit të rivlerësimit R. Jaupaj [JR nr. 21/2020 - paragrafi 68], subjektit të rivlerësimit Ç. Shahini [JR nr. 26/2020, paragrafët 28.8 dhe 29] etj.

e deklaruara nga burime financiare të ligjshme, kanë sjellë për pasojë edhe shkarkimin e saj nga detyra. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se zbatimi i nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 nga Komisioni, është i drejtë.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

*C.1. Lidhur me pasurinë e paluajtshme apartament, me sipërfaqe 121,8 m², i ndodhur në Tiranë, me adresë: rr. “{***}”, e përfutuar me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08. 2007, në shumën 4.558.000 lekë, pjesë takuese 50%.*

26. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se pasuria është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2007, bazuar në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes [më datë 27.08.2007]; pas këtij momenti bashkëshortët janë bërë pronarë të pasurisë.*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, argumenton se ndërsa kontrata e sipërmarrjes e lidhur më datë 20.12.2000 kishte për objekt apartamentin me sipërfaqe 158 m² dhe vlerë 55.300 USD, kontrata e shitblerjes [më datë 27.08.2007] e pasqyron apartamentin në sipërfaqe prej 121,8 m² dhe, pavarësisht se kontrata përcakton vlerën 48.000 USD (përfshirë shpenzimet për hipotekën dhe noterinë), në fakt është paguar vetëm 44.000 USD. Po ashtu, subjekti pretendon se apartamenti është marrë në dorëzim faktik në muajin janar 2007, pagesa është kryer me lekë në dorë, përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pala shitëse nuk ka pasur asnjë pretendim, pavarësisht diferencës prej 4.000 USD midis pagesës faktike dhe përcaktimit në kontratë. Sipas saj, “nuk i është kushtuar rëndësi çmimit” gjatë nënshkrimit të kontratës. Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti ka sjellë edhe një deklaratë noteriale nga z. A. M., lëshuar në datën 12.12.2018. Kontrata për furnizimin me ujë për apartamentin është lidhur nga shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK në vitin 2001, në emër të porositësve të apartamenteve të banimit, ndërsa në vitin 2004 bashkëshorti i saj i është drejtuar Ujësjetës për shkak të një mbifaturimi, duke qenë se kontrata e vitit 2001 figuronte në emër të L. Sh.. Kontrata me Ujësjetës Kanalizime ShA Tiranë është regjistruar në emër të bashkëshortit, në datën 01.04.2016. Ndërsa kontrata për furnizimin me energji elektrike me OSHEE-në është lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK prej datës 25.03.2002; ndryshimi në emër të bashkëshortit të saj, L. S. është kryer në datën 03.04.2018. Sipas subjektit të rivlerësimit, nëse apartamenti do të ishte përdorur që në vitin 2002, rrjedhimisht do të kishte konsum të energjisë elektrike që atë vit. Përgjatë gjithë kohës, subjekti ka banuar në Tepelenë. Pas marrjes së lejes së shfrytëzimit më datë 11.12.2006, nga Bashkia Tiranë është vijuar me lidhjen e kontratës së shitblerjes së datës 27.08.2007. Shuma 44.000 USD është siguruar nga kursimet familjare të krijuara deri në fund të vitit 2006, plus një pjesë të kursimeve deri në muajin gusht 2007. Sipas saj, në vendim nuk gjen pasqyrim asnjë argument në funksion të konkluzionit të Komisionit për kryerjen e pagesave në vitet 2003 – 2006.

26.1. Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, referuar kronologjisë së veprimeve të kryera për kalimin në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj të pasurisë objekt shqyrtimi, vërehet se:

- Më datë 20.12.2000, është lidhur kontrata e sipërmarrjes, ndërmjet bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, për një apartament me sipërfaqe 158 m², me nr. {***}, në katin e {***}, të ndodhur në rrugën “{***}”, në vlerën 55.300 dollarë amerikanë (në vijim “USD”). Sipas kontratës, pagesa do të kryhej *cash*, sipas këtij rendi: i) kësti i parë prej 35% (korrigjuar me shkrim dore 50%) të vlerës do të paguhej në momentin e nënshkrimit të kontratës; ii) kësti i dytë prej 35% (korrigjuar me shkrim dore 40%) të vlerës do të paguhej tre muaj pas nënshkrimit të kontratës; iii) kësti i tretë prej 30% (korrigjuar me shkrim dore 10%) të vlerës do të paguhej shtatë muaj pas nënshkrimit të kontratës.

- Më datë 10.12.2002, është hartuar akti i kolaudimi të godinës së banimit. Sipas këtij akti, punimet kanë filluar më datë 16.08.2000 dhe kanë përfunduar më datë 25.04.2002, pasi ishin pezulluar për rreth 3,5 muaj nga Policia e Ndërtimit [16.08.2000 – 03.11.2000]. Sipas këtij akti, është bërë lidhja e objektit me shërbimet utilitare dhe është hartuar akti i kolaudimit përfundimtar me Ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime ShA. Pagesa për lidhjet me energji elektrike, kryer për 9 abonentë familjarë, 1 dyqan dhe 1 shkallë (ambient i përbashkët), pranë llogarisë së KESh [Korporata Energjetike Shqiptare], më datë 15.02.2002. Më datë 20.12.2006, përfaqësuesi i shoqërisë “{***}” ShPK ka plotësuar kërkesën për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës së pronësisë⁴².
- Më datë 27.08.2007, shoqëria “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit, ka lidhur kontratën e shitjes me blerësin L. S., për apartamentin me sip. 121,8 m² [nr. {***}, në katin e {***}, të ndodhur në rrugën “{***}”], me çmim 48.000 USD. Në kontratë specifikohet që: *Pala shitëse [...] pasurinë [...] ia shet z. L. S. kundrejt shumës 48.000 USD [...]shumë, e cila [...] nga ana e blerësit i është likuiduar palës shitëse para përpilimit të kontratës jashtë zyrës noteriale. Blerësi deklaron se pranon blerjen e pasurisë objekt i kësaj kontrate dhe se të gjithë shumën e blerjes e ka likuiduar plotësisht [...]*.
- Më datë 15.02.2018, OSHEE informon Komisionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, dhe bashkëshorti i saj nuk rezultojnë të jenë abonentë apo të kenë kontratë furnizimi me energji elektrike. Më pas, më datë 07.12.2018, OSHEE informon z. L. S. se kontrata që i përket atij, është hapur më datë 25.02.2002, ndërsa më datë 03.04.2018 ka ndodhur ndryshimi i emrit, sipas kërkesës së klientit⁴³.
- Më datë 13.02.2018, UKT informon Komisionin se z. L. S. ka një kontratë të lidhur [me numrin përkatës] për objektin me adresë në rrugën “{***}”, ap. {***}, kati {***}, Tiranë, në kategorinë e konsumatorëve familjarë. Kontrata është e vitit 2001 dhe referuar librit të faturimit të këtij viti, figuron e regjistruar në emër të z. L. Sh.. Më datë 01.04.2016, z. L. S. ka aplikuar për ndryshimin e abonentit dhe ka dorëzuar dokumentacionin përkatës, ndër të tjera librezën e vjetër të ujit me të njëjtin numër kontrate dhe është bërë ndryshimi nga L. S. në L. S.⁴⁴.
- Më datë 12.12.2018, ish-administratori i shoqërisë “{***}” ShPK [z. A. M.] ka lëshuar një deklaratë noteriale. Sipas kësaj deklarete, me z. L. S. është lidhur kontrata e sipërmarrjes më datë 20.12.2000 dhe më datë 27.08.2007 është nënshkruar kontrata e shitblerjes për apartamentin me sipërfaqe 121,8 m², kundrejt shumës 44.000 dollarë, vlerë të cilën deklaron se e ka marrë nga blerësi z. L., përpara nënshkrimit të kontratës.

26.2. Nga deklaratat e interesave privatë për vitin 2003, rezulton që subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, dhe bashkëshorti [deklarues më vete] nuk kanë pasqyruar asnjë të dhënë lidhur me këtë pasuri, e cila sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes do të duhej të ishte likuiduar tërësisht 7 muaj pas nënshkrimit të saj – deri në muajin gusht 2001. Kjo situatë mosdeklarimi ka vijuar edhe në deklaratat e interesave privatë për vitet 2004 – 2006. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007 (dorëzuar më datë 27.03.2008), në faqen 3 [ndryshimet e pasurive], subjekti i rivlerësimit deklaron: *Sipas V.D. Hipotekor të lëshuar nga*

⁴² Referuar akteve bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 08.01.2019, të ZVRPP Tiranë, nëpërmjet të cilës është vënë në dispozicion dokumentacioni që ka shërbyer për regjistrimin e pasurisë.

⁴³ OSHEE ka bashkëlidhur në korrespondencë kërkesën e datës 24.03.2018, në rubrikën e përshkrimit të së cilës është shënuar “ndryshim, nga Firma {***} në L. S. ”.

⁴⁴ Bashkëlidhur shkresës së UKT-së gjendet dokumentacioni i administruar për abonentin L. S.: formulari i konsumit për periudhën janar 2008 – janar 2018, formulari i informacionit për abonentin, ku ndër të tjera është shënuar kontratë e re, datë hapje 30.09.2004, bashkëlidhur formulari i kërkesës me lëndë ndryshim emri, datë 01.04.2016, kartela shoqëruese me lëndë ndryshim emri, datë 01.04.2016, formulari i prezantimit të kërkesës ose ankesës nr. 1, datë 01.04.2016, kopje e faqes së parë të librezës me emrin L. S., si dhe kopje e faqes së librit të faturimit, në të cilin është shënuar emri L. Sh.. Më datë 08.12.2018, UKT-ja i ka kthyer përgjigje edhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

ZRPP Tiranë, me nr. {***}, datë 31.08.2007, në emër të bashkëshortit (L. S.) figuron e regjistruar pasuria nr. {***}, me sipërfaqe 121,8 m², {***}. Vlera e apartamentit të banimit është 44.000 mijë dollarë. Pasuria është krijuar gjatë martesës [...]. Bashkëlidhur deklaratës së atij viti gjendet një akt shtesë, në dukje i mbërritur nëpërmjet transmetimit me faksimile, më datë 04.02.2009, drejtuar ILDKPKI-së, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit deklaroi se për krijimin e apartamentit janë përdorur të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2007 dhe është pakësuar gjendja cash e deklaruar më parë, në shumën 1.500.000 lekë. Më tej, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI më datë 12.12.2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për pasurinë ka paguar gjithsej 44.000 USD, përfshirë shpenzimet për hipotekën dhe noterinë, likuidimi është bërë në dorë, duke përdorur kursimet familjare deri në vitin 2007 dhe që, sipas kursit të Bankës së Shqipërisë të datës 30.12.2005, vlera në lekë është 4.558.400 lekë dhe se kjo është shuma që realisht është paguar për apartamentin. Pyetur për arsyen për të cilën nuk e ka deklaruar këtë apartament në deklaratën e interesave private të vitit 2003 dhe mospërputhjen e vlerës së apartamentit mes kontratës së sipërmarrjes, kontratës së shitblerjes dhe asaj të deklaruar prej saj, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, është përgjigjur se: [...] Për shkak të konfliktit midis pronarëve të truallit me pronarët fqinjë, si dhe kundërshtimit të banorëve të pallatit ekzistues janë pezulluar punimet për ndërtimin e pallatit. Ky pezullim ka pasqyruar edhe moskryerjen e veprimeve financiare deri në zgjidhjen e konfliktit. Ky konflikt u zgjidh duke ndryshuar përmasat e projektit, duke e zvogëluar sipërfaqen e katit, e cila është edhe sipërfaqja e gjithë apartamentit, nga 158 m² në 121,8 m². Pas zgjidhjes së konfliktit, u ra dakord që të fillonte likuidimi i punimeve të cilat do të bëheshin në tri këste sikurse ishte përcaktuar në kontratën sipërmarrëse, por sipas ecurisë së punimeve. Duke qenë se konflikti zgjati për disa vjet dhe duke qenë se vetëm në momentin e shitblerjes dhe hipotekimit të apartamentit realisht jemi bërë pronarë të tij, ky ka qenë edhe momenti që është bërë deklarimi i kësaj pasurie [...].

26.3. Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit deklaroi se pasuria është përfituar me kontratën e shitjes të datës 27.08.2007, e blerë në shumën 4.558.000 lekë, kushtëzuar nga sipërfaqja dhe çmimi për metër katror, me kursimet familjare. Gjatë hetimit në Komision, në përgjigjet e pyetjeve 3 dhe 8 të pyetësorit⁴⁵, subjekti i rivlerësimit deklaroi: [...] Në deklaratën vetting është bërë konvertimi i shumës 44.000 USD në lekë, me kursin e këmbimit të bankës për periudhën që është kryer pagesa. [...] Pagesa është bërë me lekë në dorë para firmosjes së kontratës dhe nuk disponoj dokumentacion financiar. Kursimet për periudhën 01.01.2007 -27.08.2007 kanë qenë rreth 1.500.000 lekë dhe gjendja cash në banesë në datën 31.12.2007 ka qenë rreth 940.000 lekë. Në përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ⁴⁶, subjekti i rivlerësimit shprehet se: [...] në fakt, apartamenti është blerë me kursimet familjare të krijuara deri në fund të vitit 2006, plus një pjesë e kursimeve të vitit 2007 (faqe 2 dhe 6). Në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni më datë 11.03.2019, pyetjes së relatores mbi mënyrën e ruajtjes së parave, vendin ku është kryer pagesa dhe nëse kishte dokumente që provonin këtë pagesë, subjekti i rivlerësimit ka mohuar të ketë shprehur që blerja ka qenë për vlerën 48.000 dollarë, duke iu përmbajtur vetëm vlerës prej 44.000 dollarësh. Po ashtu, subjekti ka deklaruar se: [...] Asnjëherë nuk kemi kryer veprime dhe lekët janë dhënë përpara nënshkrimit të kontratës, në gusht të 2007 dhe pavarësisht se në fakt në janar të 2007, ky apartament na është dhënë, unë e kam cilësuar, janë dhënë me lekë në dorë, as ka pasur ndonjë pretendim [...] Për sa kohë ato nuk janë para që nuk i mbanim në bankë, sigurisht që i kemi mbajtur në shtëpi dhe i kemi dhënë.

26.4. Nga sa është parashtruar më lart, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, është kontradiktore në deklarinë e kësaj pasurie në vijimësi.

⁴⁵ Përcjellë përgjigjet me e-mail-in e datës 14.12.2018.

⁴⁶ Regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 05.04.2019.

Së pari, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjë të dhënë për këtë pasuri në vitin 2003, megjithëse kishte një kontratë porosie që në vitin 2000, që përcaktonte se duhet të kishte kryer likuidimin e çmimit brenda vitit 2001, të kishte lidhur kontratën e shitblerjes dhe në vijim të kishte fituar pronësinë e këtij apartamenti. Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, kishte detyrimin, sipas nenit 4, germa “a” e ligjit nr. 9049/2003, të deklaronte në deklaratat e interesave privatë për vitet 2003 - 2006 *pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to*, që nënkupton veprimet e ndërmarra prej saj/bashkëshortit të saj për posedimin/përdorimin e kësaj pasurie. Mosdeklarimi i kësaj pasurie dhe transaksioneve në funksion të përfitimit të saj ka vazhduar deri në dorëzimin e deklaratës së interesave privatë për vitin 2007, kur subjekti deklaroi vetëm certifikatën e pronësisë të datës 31.08.2007, me të dhënat e pasurisë dhe vlerën e saj me shënimin se “pasuria është krijuar gjatë martesës”. Së dyti, në deklaratën e vitit 2007, subjekti ka zgjedhur të mos deklarojë nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së datës 27.08.2007 apo edhe mënyrën e likuidimit të vlerës, qoftë si rezultojnë në kontratë, qoftë sikurse ka pretenduar gjatë procesit të rivlerësimit.

26.5. Për herë të parë, subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, ka deklaruar të dhëna të plota për këtë pasuri vetëm më 12.12.2014, kur është pyetur nga ILDKPKI-ja lidhur me problematikën e konstatuar në deklaratën e parë të pasurisë për periudhën para vitit 2003 dhe në deklaratat për vitet 2004 – 2013. Është me rëndësi të sillet në vëmendje se vlera e deklaruar në ILDKPKI, në shumën prej 4.558.400 lekë [pothuajse e njëjtë me vlerën e deklaruar edhe në deklaratën *vetting*] i korrespondon çmimit prej 44.000 USD, por sipas kursit të këmbimit më datë 30.12.2005, mbi një vit e gjysmë më herët nga koha e likuidimit sipas saj. Nëse vlera do të ishte konvertuar me kursin e këmbimit në kohën e pretenduar prej saj se ka ndodhur pagesa – në datën 27 gusht 2007 – vlera në lekë e 44.000 USD do të ishte ndjeshëm më e ulët, 3.951.200 lekë. Kjo përllogaritje e thjeshtë atakon deklarinimin e subjektit (në përgjigjet e datës 14.12.2018) se në deklaratën *vetting* është dhënë vlera e konvertuar në lekë e shumës 44.000 USD, me kursin e këmbimit të bankës për periudhën që është kryer pagesa. Nëse pagesa do të ishte kryer në gusht 2007, vlera e apartamentit në lekë do të ishte më e ulët. Nga ana tjetër, nëse shuma e pagesës është deklaruar saktë, nënkupton që pagesa duhet të jetë kryer në 30 dhjetor 2005 dhe jo në gusht 2007, sikurse pretendon subjekti i rivlerësimit. Mbetet i pashpjegueshëm veprimi i zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit që në datën 04.02.2009 deklaroi të ardhurat me të cilat ka krijuar këtë pasuri, ndërkohë që një gjë e tillë nuk është deklaruar në përmbajtjen e formularëve të deklaratës së interesave privatë për vitin 2007 dhe as në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008, qoftë kjo edhe në formë korrigjimi apo sqarimi plotësues.

26.6. Nga ana tjetër, referuar të dhënave të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, e konkretisht, informacionit të përcjellë nga OSHEE-ja dhe UKT-ja, rezultojnë se për këtë pasuri ka pasur kontrata të lidhura me këta operatorë që në vitet 2001 – 2002, që përkon me kronologjinë kohore sipas kontratës së sipërmarrjes dhe kohës së kryerjes së pagesave tërësisht. Po kështu, është i pakontestueshëm fakti që subjekti i rivlerësimit *ka zgjedhur* të mos sjellë asnjë dokumentacion të hartuar në kohën kur ka likuiduar tërësisht apo pjesërisht apartamentin për të provuar pagesën e kryer. Konkretisht, në kontratën e porosisë të vitit 2000 pasqyrohet vlera 55.300 USD, në kontratën e shitblerjes të vitit 2007 pasqyrohet vlera 48.000 USD, në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007 deklarohet vlera 44.000 USD, në deklaratën *vetting* pasqyrohet vlera 4.558.000 lekë (që sipas deklaratës të datës 14.12.2018, i korrespondon vlerës 44.000 USD të konvertuar me kursin e kohës që është kryer pagesa – ndërkohë kjo vlerë prodhon këtë shifër në dollarë sipas kursit të Bankës së Shqipërisë të datës 30.12.2005 dhe jo sipas kursit të gushtit 2007). Më tej, në deklaratën e datës 12.12.2014, gjatë procesit të rivlerësimit dhe në ankim, subjekti deklaroi se vlera për sipërfaqen reale të blerë ka qenë 42.630 USD ($121,8 \text{ m}^2 \times 350 \text{ USD/m}^2$), plus shpenzimet për hipotekën dhe noterinë. Së fundmi, pretendimi i subjektit se ndërtimi është shtyrë për shkak

të konfliktit disavjeçar me pronarët, bie ndesh me dokumentacionin [akti i kolaudimit] që përcakton saktësisht se pezullimi i punimeve nga Policia e Ndërtimit dhe, për pasojë, vonesa kanë zgjatur vetëm 3,5 muaj. Për këto shkaqe, pretendimi i subjektit përkundër vlerës së pagesës sipas kontratës apo kohës së kryerjes së pagesës – tërësisht në gusht 2007 – mbetet në nivel deklarativ dhe, për pasojë, jobindës.

26.7. Në përfundim të këtyre konstatimeve, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit se apartamenti është marrë në dorëzim në muajin janar 2007 dhe pagesa e gjithë shumës është kryer para firmosjes së kontratës së shitblerjes, në muajin gusht 2007, mbetet në nivel deklarativ, e pakonfirmuar me dokumentacion ligjor të kohës kur është kryer pagesa dhe bie haptazi ndesh me faktet.

- 27.** *Subjekti i rivlerësimit pretendon se analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitet 1994 – 2001 nuk qëndron pasi nuk është kryer asnjë pagesë referuar kontratës së sipërmarrjes; blerja e apartamentit është likuiduar në muajin gusht 2007, me burime financiare të ligjshme, përfshirë të ardhurat e bashkëshortit sipas vërtetimeve të lëshuara nga shoqëria “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, kontratat e punës, si dhe dokumentacioni ligjor i cili provon bindshëm marrëdhënien e punësimit dhe të ardhurat e ligjshme të krijuara.*

27.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, kontrata e sipërmarrjes për apartamentin është atipike pasi parashikon këstet e pagesave që do të kryhen në të ardhmen, por në asnjë rast nuk është përcaktuar se është paguar ndonjë këst në shumën e 50% të vlerës së apartamentit. Në ankim është pasqyruar analiza financiare në dy variante: a) në variantin e parë, analizohen të ardhurat për periudhën 1994 – 2001; dhe b) në variantin e dytë, apartamenti është blerë në vitin 2007 dhe analizohen të ardhurat e periudhës 2005, 2006 dhe 2007.

27.1.i. Në analizën financiare për periudhën 1994-2001, subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, nuk përfshin shpenzimet sipas kontratës për blerjen e apartamentit, në shumën 7.828.268 lekë. Shpenzimet e jetesës janë vendosur në vlerën prej 1.799.040 lekë⁴⁷. Sipas kësaj analize, subjekti i rivlerësimit për këtë periudhë rezulton me balancë pozitive në vlerën përfundimtare 739.336 lekë. Në analizën e parashtruar prej saj për vitet 2005, 2006 dhe 2007, për të provuar burimin e ligjshëm të pagesës së apartamentit në vitin 2007, balanca e fondeve del pozitive. Në ndryshim nga analiza e kryer gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti pretendon se një shumë prej 1.300.000 lekësh, të cilën e ka derdhur në bankë në datën 19.01.2005, vjen nga kursimet e vitit 2004. Nga ana tjetër, nisur nga data kur është dokumentuar ekzistenca e këtij fondi [janar 2005], Komisioni e ka përllogaritur të krijuar në vitin 2005. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti parashtron analizën e kryer nga Komisioni, sipas së cilës balanca e shpenzimeve dhe pasurive të krijuara me burime të ligjshme për vitin 2004, rezulton pozitive, në shumën 1.569.379 lekë.

27.1.ii. Për vitet 2006 dhe 2007, subjekti përfshin në analizë të ardhura nga punësimi – i bashkëshortit në shoqërinë “{***}” ShPK, në shumat 1.100.000 lekë dhe 1.500.000 lekë, përjashtimi i të cilave nga përllogaritja e kryer në Komision, në mungesë të pagesës së detyrimeve tatimore, është i padrejtë. Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, parashtron se përgjegjësia për të derdhur detyrimet fiskale nuk ka qenë e saj apo e bashkëshortit. Për vitin 2007, subjekti kërkon që ndryshe nga sa ka pasqyruar Komisioni bazuar në deklarin e subjektit pranë ILDKPKI-së për pakësim të kursimeve jashtë sistemit bankar [cash] prej

⁴⁷ Sipas shpjegimeve në faqet 18-20 të ankimit. Subjekti ka përzgjedhur vlerën 7.496 lekë/muaj për frymë, që duket se i përkon konsumit mujor për frymë në rajonin qendror të Shqipërisë në vitin 2002 sipas INSTAT-it. Ndërkohë, sipas përllogaritjes së kryer në Kolegji, vlera totale e shpenzimeve të jetesës për periudhën 1994 – 2001 është 1.980.977 lekë.

1.500.000 lekë në vitin 2007, duhet të merren në fakt në konsideratë shpjegimet e saj se pagesa e apartamentit në vitin 2007 është kryer nga kursimet të akumuluar nga viti 2006, shtuar edhe 2.000.000 lekë të kursyera nga të ardhurat e vitit 2007. Me fjalë të tjera, subjekti në analizë pretendon që ka përdorur kursimet *cash* për blerjen e apartamentit në vlerën 2.558.000 lekë dhe jo 1.500.000 lekë, siç ka deklaruar me aktin e dërguar me faksimile më datë 04.02.2009, në ILDKPKI.

27.1.iii. Sipas subjektit, bazuar në gjetjet e ekspertit kontabël, Komisioni nuk ka sqaruar burimin e të dhënave për shpenzimet e jetesës dhe përlllogaritjet që kryhen. Po ashtu, subjekti parashtron se për këtë zë konstatohet një mungesë koherence dhe ndryshim i madh nga njëri vit në tjetrin: për vitin 2005 dhe 2006, shpenzimet përlllogariten në vlerën 438.228 lekë, kurse për vitin 2007 në vlerën 943.872 lekë.

27.1.iv. Gjithashtu, Komisioni është kontradiktor pasi vendimi përmban dy variante lidhur me momentin e blerjes së apartamentit dhe, për pasojë, nevojitet një qëndrim. Në varësi të kohës kur prezumohet blerja e apartamentit, pagesa vlerësohet në 7.828.268 lekë në vitin 2001, dhe 3.978.720 lekë në vitin 2007. Në përfundim të analizës së pasqyruar në ankim, është konkluduar se apartamenti është paguar në vitin 2007 dhe se znj. Spaha kishte burime të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti. Sipas subjektit, Komisioni nuk duhet të ishte bazuar në të dhënat e institucioneve shtetërore, por duhet të kishte marrë në konsideratë edhe vërtetimet e lëshuara nga shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK dhe dokumentacionin e paraqitur prej saj gjatë procesit të rivlerësimit, i cili provon ligjshmërinë e të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit në këto dy shoqëri.

27.2. Nga aktet në fashikull, rezulton se Komisioni ka kryer dy analiza financiare për të verifikuar aftësinë paguese të subjektit të rivlerësimit, nisur nga mospërputhjet mes dokumentacionit dhe deklarimeve të subjektit lidhur me momentin e pagesës së çmimit të apartamentit. Në analizën e parë, për periudhën 1994 – 2001, duke konsideruar mundësinë që çmimi i apartamentit është paguar plotësisht brenda vitit 2001, sikurse parashikohet në kontratën e sipërmarrjes të datës 20.12.2000, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi të të ardhurave të mjaftueshme dhe aftësi paguese për të gjithë çmimin e përcaktuar në kontratë, duke përfshirë të ardhurat e gjithë vitit 2001 (megjithëse sipas kontratës së sipërmarrjes, kësti i fundit duhej të paguhej deri në korrik 2001). Sipas kësaj analize, subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme shumën prej 5.289.892 lekësh. Në analizën e dytë, duke pranuar hipotezën që apartamenti është paguar në vitin 2007 – siç pretendon subjekti i rivlerësimit – burimet e të ardhurave të ligjshme janë të pamjaftueshme. Nga analiza financiare e këtyre viteve, subjekti del me një balancë negative në vlerat 1.036.229 lekë dhe 665.994 lekë, përkatësisht në vitet 2005 dhe 2006 - gjë që e bën të pamundur krijimin e shtesave të *cash*-it, të deklaruara jashtë sistemit bankar [*cash* në banesë].

27.3. Në vijim të fakteve dhe arsyetimit në paragrafët 26.2 dhe 26.3 të vendimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për vlerën dhe kohën e kryerjes së pagesës janë kontradiktore në vetvete dhe bien ndesh me dokumentacionin përkatës. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar si vijon.

- Vlera e apartamentit është 44.000 USD apo 4.558.000 lekë – gjatë hetimit administrativ apo në deklaratën *vetting* – dhe jo 55.300 USD, sipas kontratës së sipërmarrjes apo 48.000 USD, sipas kontratës së shitblerjes.
- Pagesën e blerjes së apartamentit e ka kryer me para në dorë përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, duke përdorur kursimet e mbledhura deri në gusht 2007 – deklarime gjatë procesit të rivlerësimit. Në vitin 2009 ka deklaruar se janë përdorur të

ardhurat e realizuara *gjatë* vitit 2007 dhe është pakësuar gjendja *cash*, e deklaruar më parë në shumën 1.500.000 lekë. Në procesverbalin e vitit 2014, subjekti deklaroi se u dakord me shoqërinë që likuidimi i apartamentit nuk do të bëhej në tri këste, sikurse ishte parashikuar në kontratën e sipërmarrjes, por sipas ecurisë së punimeve. Subjekti nuk ka saktësuar data.

- Në procesverbalin në ILDKPKI, në vitin 2014 deklaroi se për apartamentin ka paguar shumën 4.558.400 lekë, që i korrespondon konvertimit të 44.000 USD me kursin e këmbimit më 30 dhjetor 2005. Ndërkohë, nëse vlera 44.000 USD do të ishte konvertuar me kursin e këmbimit të kohës së nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, 27.08.2007, do të rezultonte në shumën 3.951.200 lekë⁴⁸. Në mënyrë që këto shuma të ishin ekuivalentuar në treg me njëra-tjetrën, këmbimi duhet të ndodhte përrreth 20 muaj më herët.

27.4. Në funksion të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit të subjektit, Kolegji kreu analizën financiare për të vlerësuar mundësinë reale të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pagesën e kryer për këtë pasuri. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, kërkon që analiza financiare të kryhet bazuar vetëm në deklaratimet e saj kontradiktore, në prani të dokumentacionit që bie ndesh me gjithë pretendimet e saj për kohën, mënyrën e pagesës dhe vlerën e saktë të paguar për apartamentin, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje sa është shtjelluar gjerësisht më sipër, në paragrafët 26.4, 24.1 – 24.2 dhe 21.1 – 21.3 për peshën që mban dokumentacioni në funksion të provueshmërisë bindshëm të krijimit të pasurive. Ky përfundim i trupit gjykues, përpos dispozitave kushtetuese dhe ligjore të përmendura më sipër⁴⁹, bazohet edhe në detyrimin që vijon nga dispozita e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit:

“[...] 4. Komisioni dhe Kolegji i Apelitit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

27.5. Sa më sipër dhe siç është shtjelluar gjerësisht në paragrafin 24.2, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se dokumentacioni dhe faktet – kontratat utilitare për furnizim me ujë dhe drita (shtjelluar më sipër në paragrafin 26.1) – tregojnë se apartamenti duhet të ketë qenë në përdorim më parë sesa pretendon subjekti, që nënkupton se edhe pagesat duhet të jenë kryer në një kronologji që ndjek kontratën e sipërmarrjes. Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, nuk paraqiti asnjë gjurmë prove për të mbështetur pretendimet e saj.

27.6. Për sa më sipër, Kolegji kreu një analizë financiare bazuar në kontratën e sipërmarrjes, datë 20.12.2000, për vlerën e përcaktuar prej 55.300 USD, sipas kësteve të rena dakord nga palët, si i vetmi dokumentacion që ka vlerë provuese pasi është në harmoni edhe me faktet e konstatuara në rrethanat konkrete e përmban detaje pagese. Nga analiza financiare e kryer në Kolegji në këtë funksion, rezulton se *për periudhën 1994-2001*, subjekti i rivlerësimit nuk disponon të ardhura të mjaftueshme dhe aftësi paguese⁵⁰ për të gjithë çmimin e kontratës së sipërmarrjes, prej 55.300 USD, deri në fund të vitit 2001, sipas përcaktimeve të kësaj kontrate. Si rezultat i kësaj analize financiare të kryer në Kolegji, për periudhën 1994-

⁴⁸ Ndërkohë që, sipas përlllogaritjeve të Komisionit, vlera 48.000 USD është konvertuar me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 31.12.2007 (1 USD = 82,89 lekë), duke rezultuar 3.978.720 lekë.

⁴⁹ Shih poshtëshënimet nr. 40 dhe 41.

⁵⁰ Kjo analizë mbështetet në të dhënat për të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit sipas vërtetimeve të institucioneve përkatëse, ndryshimi i balancave të gjendjeve të bankës sipas konfirmimeve bankare, blerjet e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme sipas kontratave përkatëse dhe shpenzimet e jetesës në nivelin 60% të të ardhurave për periudhën 1994-1998 dhe sipas statistikave të publikuara nga INSTAT (të dhënat për vitin 2000) për periudhën 1999-2001.

2001, pamjaftueshmëria e subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit rezulton në vlerën negative prej 7.218.415 lekësh. Mungesa e burimeve të ligjshme qëndron edhe nëse përllogaritja e çmimit do të bëhej sipas vlerës së deklaruar në deklaratën *vetting*, duke rezultuar në vlerën negative prej 3.948.147 lekësh. Rezultati negativ i analizës financiare të kryer në Kolegj, rezulton dukshëm më i thellë se rezultati negativ i analizës së kryer në Komision, për shkak se Komisioni nuk ka përfshirë në analizë shpenzimet e jetesës. Në respektim të parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit në shqyrtimin në shkallë të dytë, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se mungesa e burimeve të ligjshme financiare në nivelin e përllogaritur nga Komisioni, rezulton e konfirmuar.

27.7. Duke abstraguuar nga sa më sipër, meqenëse Komisioni ka mbajtur qëndrim të dyzuar në këtë element – konstatuar me të drejtë nga subjekti i rivlerësimit në ankim – për të qenë shterues, Kolegji kreu analizë financiare *edhe* për variantin e dytë – pagesën njëherazi sipas pretendimeve të subjektit, në linjë me çfarë është kryer nga Komisioni. Kështu:

a. Në analizën financiare të kryer për vitin 2005, është mbajtur në konsideratë se në deklaratën e interesave privatë për vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar që depozita cash në bankën Raiffeisen, në emër të bashkëshortit, deri më 31 dhjetor 2004, ishte në vlerën 2.666.000 lekë. Nga nxjerrja e llogarisë së bankës, rezulton se gjendja e depozitës më 31.12.2004 ka qenë 1.365.531 lekë, ndërsa depozita është shtuar në fakt më 19 janar 2005, duke arritur shumën prej 2.666.000 lekësh. Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, në ankim ka pretenduar se këto kursime janë krijuar në vitin 2004 dhe sjell në vëmendje se, sipas përllogaritjes së kryer nga Komisioni, ajo ka rezultuar me të ardhura të mjaftueshme në këtë vit, për të mbuluar shpenzimet dhe për të krijuar kursime cash në vlerën 1.300.000 lekë. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, lidhur me detyrimin për të deklaruar [...] gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare [...] vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, [...] në lekë ose në valutë të huaj [...] ⁵¹, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte gjendjen reale të depozitës më datë 31.12.2004, pra vlerën prej 1.365.531 lekë, si dhe kursimet cash të pretenduara, në vlerën prej 1.300.000 lekësh. Mënyra e deklarimit të kryer prej saj nuk rezulton të jetë korrigjuar në asnjë nga deklaratat periodike vjetore vijuese dhe përbën një shkelje të detyrimit të saj sipas ligjit nr. 9049/2003. Nga ana tjetër, në një analizë hipotetike, në kushtet kur Kolegji si më sipër ka konstatuar një periudhë tjetër kohore kur kanë ndodhur pagesat dhe, meqenëse maturimi i depozitës bankare dhe shtimi i saj në shumën përkatëse në 19 janar 2005 konfirmohet nga dokumentacioni, në dritën e analizës financiare që rezulton me balancë pozitive për subjektin e rivlerësimit për vitin 2004, parë nga një pozitë garantiste për situatën e subjektit, analiza financiare për vitin 2005 e kryer në Kolegj do të rezultonte me balancë pozitive, në vlerën 264.282 lekë.

*b. Në analizën financiare të vitit 2006, janë mbajtur në konsideratë vetëm të ardhurat e përfituara pranë {***} sipas vërtetimit të datës 27.10.2016, bashkëlidhur të cilit gjenden dhe konfirmimet nga ISSH-ja për të ardhurat e realizuara, mbi bazën e të cilave është derdhur kontribut për periudhën 04.09.1995 – 31.03.2007 [vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare]. Ndërsa, të ardhurat nga shoqëria “{***}” ShPK, në vlerën 1.100.000 lekë, për vitin 2006, të cilat nuk janë konfirmuar nga asnjë institucion publik, nuk janë konsideruar. Shoqëria “{***}” ShPK, në vërtetimin e datës 10.12.2018, konfirmon se*

⁵¹ Në formularin e deklaratës së pasurisë, në rubrikën “Pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, të vitit 2004, kërkohet nga deklaruesit: “Në këtë seksion do të pasqyroni pasuritë e paluajtshme dhe luajtshme (në emër të deklaruesit, bashkëshortit/es dhe fëmijëve madhorë), të ndodhura brenda ose jashtë Shqipërisë deri më datë 31 dhjetor të vitit paraardhës”.

likuidimi i kësaj shume është kryer nga arka e shoqërisë – që nënkupton para në dorë. Për rrjedhojë, balanca e fondeve sipas analizës financiare të kryer në Kolegj, rezulton negative në vlerë më të lartë se ajo sipas analizës së Komisionit⁵², në bilancin negativ prej 688.831 lekë⁵³.

c. Në analizën financiare të vitit 2007, konstatohet se Komisioni ka përllogaritur të ardhurat e gjithë vitit 2007, megjithëse pagesa pretendohet të jetë kryer në datën 27.08.2007. Në këtë situatë, Kolegji kreu analizën financiare për periudhën janar-gusht 2007, për të analizuar aftësinë paguese me burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit deri në datën e kontratës së shitblerjes. Në analizën e kryer, u konsideruan të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, nga {***} për muajt janar – mars 2007 dhe dëmshpërblimi neto i përfituar për shkak të largimit nga puna, si edhe të ardhurat nga shoqëria “{***}” ShPK për periudhën prill – korrik 2007, në vlerën e konfirmuar nga institucionet për përmbushjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe tatimeve⁵⁴. Ndërkohë, nga dokumentacioni i administruar, rezulton se nuk vërtetohet përfitimi i pretenduar për të ardhurat e likuiduara në *cash*, nëpërmjet arkës nga shoqëria “{***}” ShPK [të dhëna të detajuara jepen në nënparagrafin 32.2.3, pika i]. Vlera e të ardhurave neto, e derivuar nga të dhënat mbi pagën bazë, është e përafërt me vlerën e konfirmuar edhe nga vërtetimi i shoqërisë “{***}” ShPK, si pagesë për paga (325.481 lekë). Pagesat në formën e *dietave* dhe *shpërblimeve* (prej 1.174.519 lekë) nuk provohen nga dokumentacioni i administruar në dosje⁵⁵. Trupi gjykues, për ekonomi gjyqësore, çmoi të mos vijonte me hetimin për këtë fakt pasi edhe nëse do të rezultonte sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, edhe ky fakt nuk do të ndikonte në zgjidhjen e çështjes. Po ashtu, nuk provohet raporti mes këtyre dy kategorive, që do të mundësonte zbritjen e *dietave*, duke pasur parasysh natyrën e tyre – dhënë për të mbuluar shpenzime të pritshme apo të kryera – nga kategoria e burimeve financiare që teorikisht krijojnë pasuri, në përputhje edhe me jurisprudencën e mëparshme të Kolegjit, sipas së cilës *dietat* për nga natyra nuk mund të argumentohen si burim të ardhurash, pasi janë pagesë e një shpenzimi jetik të kryer⁵⁶. Si rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se shumata e pretenduara të përfituara nga personi i lidhur/subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, mbetën në nivel deklarativ e, për pasojë, vlerësimi i saktë i tyre, në funksion të burimeve të ligjshme në kontekstin e procesit të rivlerësimit, mbetet i pamundur. Po kështu, në kushtet kur subjekti ka dështuar të paraqesë prova për të vërtetuar raportin ndërmjet vlerës së *dietave* dhe të *shpërblimeve*, analiza financiare u bazua në dokumentacionin e përcjellë nga institucionet publike (sigurime shoqërore dhe tatime). Trupi gjykues vëren se në çdo skenar të mundshëm mbi vlerat e të ardhurave, qoftë edhe atyre të pretenduara në deklaratat periodike vjetore dhe në ankim nga subjekti i rivlerësimit, duke abstraguuar për shkak të argumentit nga mungesa e dokumentacionit provues, pavarësisht nga

⁵² Balanca e fondeve për vitin 2006, sipas Komisionit, është në vlerën negative 665.994 lekë – faqe 9 e vendimit.

⁵³ Për shkak të metodologjisë së ndryshme të përdorur nga Kolegji për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, këto të fundit rezultojnë më të larta se përllogaritja e kryer nga Komisioni për këtë zë.

⁵⁴ Shkresa e Drejtorisë Rajonale Fier (ISSH) datë 20.11.2018, sipas së cilës paga mbi të cilën është derdhur kontribut në muajin prill 2007 është në vlerën 25.300 lekë, në muajin maj 2007 në vlerën 36.650 lekë dhe për periudhën qershor 2007 – korrik 2008 në vlerën 48.000 lekë në muaj. Sipas shkresës së Drejtorisë së Arkivit Qendror (ISSH), datë 06.02.2019, disponohen listëpagesa vetëm për periudhën gusht 2009 – gusht 2010, të ardhurat mbi bazën e të cilave është derdhur kontribut, janë për pagën bruto 70.000 lekë në muaj.

⁵⁵ Shkresa e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, datë 15.01.2019, sipas së cilës, nga bilancet e dorëzuara dhe kontrollat tatimore të ushtruara për subjektin “{***}”, për periudhën 2006 – 2010, shpenzimet e deklaruara për dieta janë në shumë totale – nuk specifikohen individët përfitues dhe as sa nga këto shpenzime janë për udhëtime dhe sa për dieta. Konkretisht, për vitin 2006, shuma e *dietave* është në vlerën 204.000 lekë; për vitet 2007 dhe 2008 shuma e *dietave* është në vlerën 0 lekë, për vitin 2009 shuma e udhëtimeve, *dietave* është në vlerën 813.070 lekë dhe për vitin 2010 shuma e *dietave* është në vlerën 20.975.965 lekë

⁵⁶ Shih vendimin e Kolegjit që lidhen lidhet me subjektin e rivlerësimit E. Sadiku [JR nr. 07/2019], paragrafët 34 dhe 36, vendimin që lidhet me subjektin e rivlerësimit A. Belishta [JR nr. 01/2020], paragrafi 15 dhe vendimin që lidhet me subjektin e rivlerësimit A. Dollapaj [JR nr. 04/2020], paragrafi 61.

ndonjë efekt pozitiv mbi bilancin e viteve të veçanta – si për shembull, për vitin 2007 – gjithsesi, pamundësia financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme afekton vite të tjera të periudhës së procesit të rivlerësimit dhe konkretisht vitet 2013, 2014 dhe 2015.

27.8. Në përfundim, sipas analizës financiare për vitet 2005, 2006 deri në gusht 2007, të kryer në Kolegj, duke përfshirë edhe skenarët e mundshëm garantistë, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk disponon të ardhura të mjaftueshme dhe aftësi paguese për të gjithë çmimin e kontratës së apartamentit në muajin gusht 2007 (përlllogaritur sipas vlerës së deklaruar në deklaratën *vetting* prej 4.558.000 lekësh), pasi nuk justifikon me burime të ligjshme shumën prej 1.089.614 lekësh.

- 28.** Sikurse është arsyetuar më sipër, analiza financiare e kryer në Kolegj është mbështetur në të ardhurat, vlera dhe pagesa e të cilave provohet me dokumentacion zyrtar dhe për të cilat provohet ligjshmëria nëpërmjet pagesës së detyrimeve tatimore. Ky qëndrim bazohet në kërkesat kushtetuese dhe ligjore lidhur me të provuarin bindshëm të vlerës së të ardhurave me dokumentacion dhe ligjshmërisë së tyre, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 32, pikat 1 dhe 2; 49, pika 4 dhe 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Së fundmi, ky arsyetim është në përputhje edhe me jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit lidhur me burimet e të ardhurave që do të quhen të ligjshme dhe do të përfshihen në përlllogaritjen e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të⁵⁷, si dhe për vlerat e kursimeve/gjendje *cash* të deklaruara gjatë procesit të rivlerësimit, të ndryshme nga deklaratimet në deklaratat vjetore periodike⁵⁸. Dispozitat e cituara më sipër, për lehtësi leximi riprodhohen më poshtë sipas radhës.

Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës:

[...] Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj [...].

Neni 32, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016:

[...] 1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.
2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor [...].

Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016:

[...] 4. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas

⁵⁷ Shih: <http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-A.-Sevdari-i-anonimizuar-perpublikim.pdf>, <http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/11/Vendim-Donika-Prela-anonimizuar.pdf>.

⁵⁸ Shih: http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh_Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralel.pdf; <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/11/Vendimi-p%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-G.-Osmani-I-ANONIMIZUAR.pdf>; http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendimi_Dritan-Peka_i_anonimizuar_per_web.pdf.

bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...].

Neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016:

“Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat [...].

28.1. Në përmbledhje të sa më sipër, duke marrë në konsideratë qëndrimin e trupit gjykues për moskryerjen e hetimeve të mëtejshme për shkak se kjo e dhënë nuk do të afektonte zgjidhjen e çështjes [paragrafi 27.7.c më sipër], Kolegji konstaton dhe vlerëson se një pjesë e të ardhurave të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit nga punësimi i bashkëshortit në shoqërinë “{***}” ShPK, nuk kalojnë testin e provueshmërisë e, për pasojë, edhe testin e ligjshmërisë së tyre. Në këto kushte, për trupin gjykues të Kolegjit, vlerësimi i saktë i të ardhurave të ligjshme për këtë element nuk u mundësua as në funksion dhe zbatim të barrës së provës nga subjekti i rivlerësimit. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit që synon ta trajtojë çështjen në kuadër të detyrimeve të shoqërisë “{***}” ShPK, nuk është bindës. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për përfitimin e këtyre të ardhurave sipas vërtetimeve të shoqërisë, mbeten në nivel deklarativ, të padetajuara në ndonjë formë që do të konfirmonte raportin mes shpërblimeve dhe shpenzimeve të kryera [dietave]. Për pasojë, vlerësimi i saktë i të ardhurave të ligjshme, në funksion të kontrollit të kriterit pasuror në procesin e rivlerësimit, u mundësua vetëm mbi bazën e dokumenteve nga institucionet shtetërore.

29. Nga aktet në fashikull, rezulton se për periudhën 1994 – 2001, Komisioni nuk ka përlogaritur shpenzime jetese. Ndërkohë, vlerat e pasqyruara nga Komisioni në analizën financiare për zërin shpenzime jetese për vitet 2005 dhe 2006, krahasimisht më të ulëta se për vitin 2007, u referohen të dhënave të përcjella nga ILDKPKI-ja me shkresën e datës 29.01.2019⁵⁹. Në rezultatet e hetimit administrativ (faqe 28), Komisioni është shprehur se në kryerjen e analizës financiare për periudhën 2005-2016 (periudhë e deklaramëve të gjendjeve *cash*), për shpenzimet jetike i është referuar raportit të ILDKPKI-së. Kjo nënkupton që, ndryshe nga sa pretendon në ankim, subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni të burimit të referencës për shpenzimet në fjalë dhe metodologjisë. Më tej, vlerat e përdorura nga Komisioni dhe ILDKPKI-ja bazohen në shkresat vjetore të INSTAT-it dhe publikimet e këtij të fundit mbi tregues të Anketës së Buxhetit të Familjes dhe/ose Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës, çka do të thotë që janë vlera të prejardhura nga një burim zyrtar. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerat e shpenzimeve të jetesës, është i pabazuar dhe i pakuptimtë.

30. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, apartament me sipërfaqe 121,8 m², të ndodhur në adresën: rr. “{***}”, Njësia nr. {***}, Tiranë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

C.2. Lidhur me pasurinë e luajtshme automjet “Toyota Rav. 4”, i blerë nga bashkëshorti i subjektit në shumën prej 906.000 lekësh, datë 7.10.2013 (në bashkëpronësi 50% me 50% nga prezumimi i bashkëpronësisë me bashkëshortin)

31. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, pretendon se ka burime të ligjshme për pasuritë e krijuara gjatë vitit 2013. Sipas saj, Komisioni, në kryerjen e analizës financiare të vitit 2013, ka përdorur të njëjtën logjikë sikurse edhe për vitet e mëparshme, dhe nuk jep sqarime në lidhje me burimin e shifrave që përmenden në zërin e shpenzimeve të jetesës. Për rrjedhojë,*

⁵⁹ Nr. {***} prot. – regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 29.01.2019.

sipas saj, është e pamundur për të që të konfirmojë saktësinë e shifrave të përdorura. Subjekti i rivlerësimit argumenton se Komisioni nuk është koherent në lidhje me këtë zë në analizat e kryera nga viti në vit, gjë që pamundëson edhe çdo analizë statistikore të trendit të këtij zëri, për vitet 2005, 2006, 2007, 2011 dhe 2013. Sipas subjektit, në vitin 2013 familja përbëhej vetëm nga 3 veta, pasi i biri ishte në shkollë në Tiranë. Bazuar në të dhënat e INSTAT-it, konsumi total vjetor për tre persona është 330.696 lekë. Po ashtu, nëse zbriten nga konsumi total shpenzimet për transport, që zakonisht janë karburant dhe transport, shpenzimet duhet të rezultojnë në vlerën 264.557 lekë. Po kështu, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka përfshirë në të ardhurat nga qiraja për këtë vit shumën 660.000 lekë dhe jo 720.000 lekë, sikurse është deklaruar në deklaratat e interesave privatë për vitet përkatëse, duke zbritur tatimin e qirasë, ndërkohë që tatimi është paguar në vitin 2014. Nëse shtohet vlera 720.000 lekë nga të ardhurat e qirasë, balanca e fondeve, sipas analizës së kryer nga eksperti kontabël, rezulton pozitive, shton subjekti.

31.1. Nga analiza financiare e kryer për vitin 2013, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme në shumën 346.495 lekë për blerjen e automjetit, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera të analizuara. Komisioni argumenton se për efekt të analizës financiare, u është referuar të dhënave mbi konsumin vjetor për frymë, sipas shkresës së INSTAT-it, përcjellë nga ILDKPKI-ja më datë 29.1.2019. Sipas kësaj shkrese, anketat mbi të cilat bëhet përlllogaritja kanë për bazë shpenzimet minimale në shkolla shtetërore dhe [...] nuk përfshihen shpenzimet për shkollim në institucione jopublike [...]. Shpenzimet e dokumentuara të shkollimit në shkollë private dhe të transportit (të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si shpenzime për autoveturën) janë shtuar mbi shpenzimet sipas INSTAT-it, për shkak se në mënyrë të shprehur nuk përfshihen në shpenzimet minimale; shpenzimet e transportit të kryera nga subjekti dukshëm janë më të larta, duke qenë në total afro 62% e konsumit vjetor të familjes, referuar të dhënave nga INSTAT-i. Komisioni ka llogaritur 660.000 lekë si të ardhura nga qiraja për vitin 2013. Në këto shpenzime, Komisioni nuk ka përfshirë transfertat bankare në shumën prej 170.000 lekësh të bashkëshortit të subjektit, drejtuar një të treti [z. A. S.]; nga ana tjetër, Komisioni ka zbritur nga vlera mesatare e shpenzimeve të karburantit shumën prej 13.500 lekësh dhe shumën prej 4.200 lekësh në muaj (200 lekë në ditë x 21 ditë), të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit. Këto shuma u përkasin shpenzimeve të transportit me mjete të tjera, të përfshira në shpenzimet e konsumit vjetor për frymë. Në analizën financiare pasqyrohet si shpenzim karburanti shuma e reduktuar 102.300 lekë në vit: (13.500 lekë – 4.200 lekë) x 11 muaj.

31.2. Nga dokumentacioni i administruar në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

31.2.1. Djali i subjektit të rivlerësimit [J. S.] ka ndjekur studimet në kolegjin “{***}”, Tiranë, në periudhën 2013 – 2016. Në marrëveshjet e lidhura midis z. S. dhe përfaqësuesit të institucionit arsimor për vitin 2013, specifikohen datat e fillimit e të mbarimit të studimeve [09.09.2013 – 06.06.2014]. Po ashtu, specifikohet se pagesa e shkollës përfshin mëngjesin dhe drekën. I njëjti specifikim gjendet edhe në marrëveshjen e lidhur për vitin arsimor 2014, ku përcaktohet kohëzgjatja e programit arsimor [06.09.2014 – 05.06.2015] dhe dy vaktet që përfshihen në pagesë. Ndërsa në marrëveshjen për vitin arsimor 2015, përveç kohëzgjatjes së programit arsimor [07.09.2015 – 10.06.2016], specifikohet se shkolla do të mbulojë akomodimin dhe ushqimin për tri vakte. Referuar korrespondencës me fondacionin {***}⁶⁰, kostoja financiare për të gjitha vitet, që nga momenti i regjistrimit, për periudhën 2013 –

⁶⁰ Shkresa nr. {***} prot., datë 21.12.2018.

2016, është në total 850.275 lekë⁶¹. Në përgjigje të pyetësorit [të datës 15.01.2019], subjekti është shprehur se shpenzimet në total, përfshirë konviktin, arsimimin, uniformat dhe librat, janë në vlerën 921.450 lekë. Përveç tyre, për nevoja të tjera plotësuese i janë dërguar djalit shuma në vlerën rreth 10.000 lekë në muaj. Në përgjigjet e datës 15.01.2019, subjekti ka shpjeguar se transfertat bankare në drejtim të z. A. S. nga bashkëshorti i subjektit kanë qenë për të mbuluar nevoja të pagesës së shkollimit [3 transfertat me një total prej 170.000 lekësh gjithsej në vitin 2013]. Duke mos pasur llogari në bankën ku kishte një llogari bankare institucioni arsimor, bashkëshorti i saj ka transferuar para në llogari të nipit të tij, me qëllim që ai të bënte kalimin te llogaria e shkollës.

31.2.2. Në vijim të sa më sipër, në analizën financiare të kryer në Kolegj për vitin 2013, shpenzimet e shkollimit janë përfshirë në vlerën 190.000 lekë, që përbëhet nga shuma e tarifës së paguar për institucionin arsimor [150.000 lekë] dhe vlerat e dërguara në baza mujore, sipas deklaramit të subjektit riprodhuar më sipër [10.000 lekë/muaj \times 4 muaj = 40.000 lekë]. Shpenzimet e jetesës janë përlloritur sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT-i, për një familje me *tre* (3) persona për muajt e shkollës, dhe *katër* (4) persona për muajt e tjerë, duke e vlerësuar pjesërisht të drejtë pretendimin e subjektit për përlloriturjen e shpenzimeve të jetesës për 3 persona.

31.2.3. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha, për pakësimin e shpenzimeve të jetesës me 20% të konsumit total vjetor, pasi sipas një përlloriturjeje të saj, kjo përqindje e shpenzimeve totale të konsumit⁶² u përket shpenzimeve për konsum joushqimor, të cilat janë zakonisht shpenzime për karburant dhe transport, meqenëse në rastin e saj shpenzimet e transportit janë paraqitur si zë më vete, nuk qëndron. Rezulton se në analizën e kryer nga Komisioni, së pari shpenzimet e transportit janë për shkak të karburantit të shpenzuar nga subjekti për transport ndërqytetës [udhëtimet e përditshme Tepelenë - Gjirokastrë e kthim]. Ky shpenzim është qartësisht më i lartë sesa nëse subjekti do të punonte e jetonte në të njëjtin qytet. Së dyti, grupi i shpenzimeve për konsum joushqimor të përlloritur nga INSTAT-i, nuk përfaqësohet vetëm nga shpenzimet e transportit, të cilat gjithsesi përbëjnë vetëm rreth 7% të totalit [konsum joushqimor]. Përlloriturja e subjektit në 20% të shpenzimeve totale, është e pasaktë. Është e rëndësishme të silltet në vëmendje se në këtë zë, përveç karburantit dhe shpenzimeve të transportit urban, INSTAT-i parashikon/përfshin edhe shpenzime të tjera, të palidhura me transportin⁶³, të evidentuara më vete në analizën e Komisionit. Së treti, Komisioni shprehet në vendim se në analizën përfundimtare, ka zbritur nga vlera mesatare e shpenzimeve të karburantit prej 13.500 lekësh/muaj, shumë prej 4.200 lekësh në muaj (200 lekë në ditë \times 21 ditë pune), e cila i përket transportit me mjete të tjera, të përfshira në shpenzimet e konsumit vjetor për frymë. Për rrjedhojë, përlloriturja e kryer nga Komisioni, për sa u përket shpenzimeve të transportit, është e saktë.

31.2.4. Më datë 07.10.2011, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka lidhur kontratën e qirasë me z. P. R. [qiramarrësi] për apartamentin në Tiranë, për 5 vjet, për periudhën 01.10.2011

⁶¹ Respektivisht: për vitin 2013 janë paguar 150.000 lekë, për vitin 2014 janë paguar 250.000 lekë, për vitin 2015 janë paguar 270.275 lekë dhe për vitin 2016 janë paguar 180.000 lekë.

⁶² Subjekti i rivlerësimit është bazuar në publikimet e INSTAT-it për AMNj-në (Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës) – statistika për rajonin qendror. Në analizat financiare të kryera në Kolegj, shpenzimet e jetesës për vitin 2013 përlloritur në linjë me ILDKPKI-në (bazuar në shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2019), sipas statistikave të INSTAT-it për AMNj-të (Anketat e Buxhetit të Familjes), mbi të dhënat e rishikuara të konsumit mesatar për frymë shumëzuar për numrin e personave në familje.

⁶³ Në këtë grup përfshihen, ndër të tjera, shpenzime për taksat vjetore, siguracionet dhe kolaudimet e automjeteve. Referuar metodologjisë që përdor INSTAT-i në përlloriturjen e shpenzimeve për grupin “transport”, rezultojnë shpenzimet për të gjitha llojet e makinave, të reja dhe të përdorura, taksit, bileta avionësh, të gjitha llojet e biletave naftë, gaz, pjesë këmbimi dhe riparime, garazhe etj.: <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/#tab4>

deri më 01.10.2016. PAGESA mujore e përcaktuar nga palët është në vlerën 60.000 lekë, që do të paguhet në dorë në fillim të çdo muaji. Më datë 27.12.2013, palët kanë nënshkruar revokimin e kontratës për shkak të mospërdorimit të banesës nga qiramarrësi. Nga shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër [e datës 19.03.2019], rezulton se pagesa e tatimit në burim për qira godine nga z. L. S. është kryer në datën 27.11.2014, në shumën 156.000 lekë, sipas vetëdeklarimit për kontratën e qirasë, për periudhën 07.10.2011 – 27.12.2013, e ndarë sipas periudhave⁶⁴. Nga transaksionet bankare rezulton se pagesa e tatimit është kryer në një veprim të vetëm⁶⁵, me përshkrimin: *Pagesë për tatimin në burim për qira godine nga L. S. për periudhën 07.10.2011 - 27.12.2013*. Nga sa më sipër, rezulton një diferencë prej 6.000 lekësh midis detyrimit tatimor për t'u paguar në vlerën 162.000 lekë dhe detyrimit të paguar realisht nga z. S., në vlerën 156.000 lekë. Kjo diferencë i korrespondon tatimit mbi qiranë e një muaji (60.000 lekë/muaj). Nga kjo përllogaritje, rezulton se ndonëse qiraja deklarohet për 27 muaj, në fakt tatimi është paguar për një muaj më pak, pra për 26 muaj (sipas vetëdeklarimit - 2 muaj në vitin 2011, 12 muaj në vitin 2012 dhe 12 muaj në vitin 2013). Nëse do të abstragohej ky fakt për të evituar arbitraritetin, duke i konsideruar të ardhurat nga qiraja të plota për vitin 2013 [720.000 lekë], rezultati i analizës financiare për këtë vit do të rezultonte sërish me bilanc fondesh negativ (275.594 lekë⁶⁶).

31.3. Në përfundim, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, duke marrë në konsideratë në mënyrë të pjesshme pretendimet e subjektit të rivlerësimit, rezulton se lidhur me pasurinë automjet tip “Toyota Rav. 4”, blerë në shumën 906.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, në shumën 275.594 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se edhe sikur të pranohet për hir të argumentit çdo skenar i mundshëm teorik apo në shërbim të shterimit të gjithë alternativave mbi të ardhurat e pretenduara nga punësimi i bashkëshortit (referuar deklaratave periodike të pasurisë), sërish subjekti i rivlerësimit rezulton se gjendet në situatën e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve të deklaruara për vitin 2013.

C.3. Lidhur me pikat 5, 6, 7, 8 dhe 9 të vendimit, që lidhen me llogaritë dhe depozitat bankare – llogaria rrjedhëse në Bankën Societe Generale Albania, në emër të subjektit të rivlerësimit, llogaria rrjedhëse në bankën Intesa SanPaolo, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, llogaria rrjedhëse dhe depozita në bankën Raiffeisen [e krijuar prej vitit 1988 në Bankën e Kursimeve] në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe depozita në BKT (në bashkëpronësi)

32. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka burime të ligjshme për kryerjen e veprimeve financiare që kanë furnizuar me fonde këto llogari dhe depozita bankare. Sipas subjektit:*

i) Analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2014, është inkohente sa u përket shpenzimeve të jetesës. Komisioni nuk tregon burimin të cilit i referohet për përllogaritjen, përdor shifra që nuk kanë lidhje logjike – ka ndryshime të mëdha nga njëri vit në vitin tjetër. Të dhënat e INSTAT-it nuk mund të kenë një ndryshim kaq të madh nga viti 2013 në vitin 2014. Sipas subjektit, konsumi total vjetor për 3 veta për 2014, përllogaritet në 363.766 lekë [duke qenë se djali J. S. ka jetuar në konviktin e shkollës në Tiranë]. Subjekti bën një përllogaritje të shpenzimeve të jetesës vit pas viti, duke përdorur si bazë vitin 2012 dhe shtuar

⁶⁴ *Periudhat janë: nëntor – dhjetor 2011 – 60.000 lekë x 10% tatim në burim = 12.000 lekë; janar – dhjetor 2012 – 60.000 lekë x 10% tatim në burim = 72.000 lekë; dhe janar – dhjetor 2013 – 60.000 lekë x 10% tatim në burim = 72.000 lekë.*

⁶⁵ *Veprim i kryer pranë Alpha Bank në datë 27.11.2014.*

⁶⁶ *Vlerë më e vogël krahasimisht me vlerën e nxjerrë nga Komisioni (346.495 lekë).*

10% në vitet në vijim. Si pasojë e kësaj metodologjie, balanca e fondeve për vitin 2014 do të rezultojë në vlerën [pozitive] prej 361.728 lekësh. Duke ndjekur të njëjtën metodë, për vitin 2015, balanca fondeve rezulton në vlerën 488.904 lekë.

ii) Për sa i përket llogarisë së kursimit të bashkëshortit në Raiffeisen Bank, të ardhurat e bashkëshortit nga punësimi duhet të bazohen në vërtetimet e dy shoqërive. Detyrimin për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, e ka punëdhënësi, e vlerësuar kjo edhe në kontekstin e realitetit shqiptar lidhur me informalitetin në marrëdhënien e punësimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, të ardhurat neto të bashkëshortit nga paga, dietat dhe shpërblimet mujore për periudhën 2006 – 2010, nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShPK, kanë qenë në shumën 6.600.000 lekë dhe janë pasqyruar në deklaratat e interesave privatë respektive dhe në deklaratën *vetting*. Një pjesë e të ardhurave janë paguar *cash* nga arka e shoqërisë. Shoqëria nuk e disponon dokumentacionin lidhur me pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për shkak të kohës së gjatë. Të ardhurat e bashkëshortit për periudhën 2010 – 2014, nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShPK, kanë qenë në shumën 4.988.640 lekë. Për të provuar marrëdhënien e punësimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratat dhe librezën e punës, vërtetime nga shoqëritë, libreza masash, vërtetime nga institucione dhe dokumente të tjera provuese. Meqenëse pagesa bëhej *cash* nga arka, nuk disponohet dokumentacion provues.

Subjekti i rivlerësimit ka mbështetur argumentet lidhur me detyrimin e punëdhënësit për kryerjen e pagesave të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi në ligjin nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në RSh”, i ndryshuar (neni 13), ligjin nr. 9136, datë 11.09.2013, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSh”, i ndryshuar (neni 6), ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në RSh”, i ndryshuar (neni 11), ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (nenet 8/a dhe 10), ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSh”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, të ministrit të Financave “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (pika 2.6.2.).

32.1. Pas analizës financiare për kohën e krijimit të llogarive, e konkretisht vitet 2014, 2015 dhe periudhën 1994 - 2016, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për krijimin respektivisht:

a) të gjendjes në shumën 154.498 lekë, në llogarinë *rrjedhëse* në bankën Societe Generale Albania;

b) të gjendjes në shumën 8.057 lekë në llogarinë *rrjedhëse* në bankën Intesa San Paolo;

c) të depozitës bankare në bankën Raiffeisen (në vlerën 4.944.512 lekë në datën 24.01.2017), krijuar në vitin 1988 në Bankën e Kursimeve, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme (nga puna e bashkëshortit në periudhën 1994 - 2016) në shumën 7.591.355 lekë⁶⁷. Komisioni ka konstatuar po ashtu se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga punësimi pranë shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, sipas vërtetimeve, nuk përputhen me të ardhurat e rezultuara në dokumentacionin zyrtar të siguruar gjatë hetimit administrativ. Nga këto të fundit, rezultoi se personi i lidhur ka përfituar 7.591.355 lekë më pak nga sa ka deklaruar në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit⁶⁸.

32.2. Në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit pasqyruar në këtë shkak ankimi, Kolegji kreu një analizë financiare për vitet dhe periudhat kohore gjatë të

⁶⁷ Komisioni ka trajtuar bashkërisht në analizën dhe arsyetimin e kryer depozitën te BKT në bashkëpronësi (pika 9 e vendimit) gjendjen *cash* të deklaruar në vlerën 1.200.000 lekë (pika 10 e vendimit).

⁶⁸ Nga shoqëria “{***}” ShPK, sipas dokumentacionit zyrtar, bashkëshorti i subjektit ka përfituar 4.942.207 lekë më pak, ndërsa nga shoqëria “{***}” ShPK ka përfituar 2.649.148 lekë më pak.

cilave janë krijuar apo shtuar këto pasuri të luajtshme – llogari bankare. Si rrjedhojë, në përmbledhje të analizës financiare, dokumentacionit të administruar dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues i Kolegjit vëren sa vijon.

32.2.1. Shpenzimet e jetesës nga Komisioni janë përlllogaritur sipas të dhënave të përcjella nga ILDKPKI me shkresën e datës 29.01.2019⁶⁹, sipas burimit statistikor të përcjellë nga INSTAT-i dhe përdorimi i tyre vlerësohet i drejtë. Për rrjedhojë, pretendimi dhe përlllogaritja e kryer nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në hamendësim të indeksit të rritjes së çmimeve prej 10%, duke qenë e pabazuar në burime zyrtare, nuk qëndron.

Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës sipas numrit të anëtarëve të familjes gjatë kohës kur njëri prej tyre [djali] jeton veçmas gjatë studimeve në Tiranë, në vijim të arsyetimit në paragrafët 31.2.1, dhe 31.2.2 të këtij vendimi, analiza e kryer në Kolegj është mbështetur në dokumentacionin shkresor të administruar në fashikull – detajuar më sipër në paragrafin 31.2.1. Për rrjedhojë, duke marrë në konsideratë sa rezulton nga dokumentacioni, e konkretisht që për vitin shkollor 2014-2015, darka dhe akomodimi *nuk* përfshihen në tarifën e shkollimit, shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur duke reflektuar kohëzgjatjen e vitit akademik dhe referuar të dhënave të publikuara nga INSTAT-i. Si rezultat, vlera e përlllogaritur është totali i shpenzimeve mesatare mujore për një familje me katër persona për muajt qershor - gusht 2014 (3 muaj x 73.333 lekë) dhe për një familje me tre persona për 9 muajt e tjerë të vitit 2014 (9 muaj x 55.000 lekë). Duke ndjekur të njëjtën logjikë, meqenëse pagesa për vitin shkollor 2015 - 2016 konfirmohet se *përfshin* akomodimin dhe 3 vaktet, për 4 muajt e fundit të vitit 2015 dhe 5 muajt e parë të vitit 2016, familja e subjektit të rivlerësimit është përlllogaritur për tre (3) anëtarë. Si rezultat, për vitin 2015, shpenzimet e jetesës, sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT-i, janë përlllogaritur për një familje me katër persona për muajt qershor - gusht 2015 (3 muaj x 74.759 lekë) dhe për një familje me tre persona për 9 muajt e tjerë të vitit 2015 (9 muaj x 56.069 lekë). Në përfundim, në analizën financiare të kryer në Kolegj, janë reflektuar pjesërisht pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për sa i përket numrit të anëtarëve të familjes, duke i përlllogaritur me 3 dhe 4 anëtarë sipas periudhave të ndara të viteve 2014 dhe 2015.

32.2.2. Në funksion të analizës financiare sa më sipër, për vitet 2014 dhe 2015, Kolegji konsideroi edhe shpenzimet e shkollimit të personit të lidhur, djalit të subjektit të rivlerësimit. Në këtë kontekst, në analizë është përfshirë tarifa e paguar për shkollimin për secilin vit, respektivisht 250.000 lekë dhe 270.275 lekë. Përveç këtyre pagesave për tarifën e shkollimit, në përlllogaritje janë pasqyruar në shpenzime edhe fondet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dërguar të birit për nevoja të tjera plotësuese, në vlerën 10.000 lekë në muaj, konfirmuar me të dhënat e transfertave bankare të kryera nga bashkëshorti të z. A. S., në funksion të pagesave të shkollimit të të birit.

32.2.3. Lidhur me të ardhurat nga punësimi në shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, nga dokumentacioni rezulton sa vijon:

i) Sipas librezës së punës, z. S. ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “{***}” ShPK për periudhën prill 2007 – gusht 2010. Sipas kontratës së punës së datës 09.05.2008, e lidhur për një periudhë 2-vjeçare, duke filluar nga data 1 maj 2008, paga mujore është 50.000 lekë dhe shpërblime, të cilat do të paguhen në fund të çdo muaji. Sipas kontratës, punëdhënësi do t’i sigurojë punëmarrësit të drejtat që burojnë nga ligji për sigurimet shoqërore. Sipas vërtetimit të datës 27.11.2014 të shoqërisë “{***}” ShPK, z. L. S., në vitin 2006 ka punuar me kohë të pjesshme pranë kësaj kompanie dhe për punën e kryer është shpërblyer në shumën 1.100.000

⁶⁹ Nr. {***} prot. – regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 29.01.2019.

lekë. Prej vitit 2007 e deri në 31 gusht 2010, ka punuar me kohë të plotë në detyrën e drejtuesit teknik dhe është paguar në vlerën totale 5.500.000 lekë, që përfshin pagën, plus shpërblime, plus dieta. Sipas vërtetimit të datës 10.12.2018, të shoqërisë “{***}” ShPK, z. L. S. për punën e kryer do të paguhej me pagë bruto 50.000 lekë dhe me shpërblime dhe shtesa mbi pagë sipas kontributit në punë. Shoqëria informon se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, mandatpagesat e kryera nga arka janë asgjësuar pas mbylljes së bilanceve vjetore dhe miratimit të tyre dhe për këtë shkak nuk disponojnë as dokumentacion në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi. Sipas vërtetimeve të lëshuara nga shoqëria, për vitet 2006 – gusht 2010, z. L. S. është paguar si vijon:

- për vitin 2006 është paguar 1.100.000 lekë⁷⁰, likuiduar nga arka;
- për vitin 2007 është paguar 1.500.000 lekë⁷¹, nga të cilat është kryer nëpërmjet bankës pagesa për pagën në shumën 325.481 lekë dhe janë paguar nga arka shpërblime, plus dieta në shumën 1.174.519 lekë;
- për vitin 2008 është paguar 1.500.000 lekë⁷², nga të cilat është kryer nëpërmjet bankës pagesa për pagën në shumën 453.888 lekë dhe janë paguar nga arka për shpërblime, plus dieta në shumën 1.046.112 lekë;
- për vitin 2009 është paguar 1.500.000 lekë⁷³, nga të cilat është kryer nëpërmjet bankës pagesa për pagën në shumën 540.568 lekë dhe janë paguar nga arka shpërblime, plus dieta në shumën 959.432 lekë;
- për vitin 2010 (janar – gusht) është paguar 1.000.000 lekë, nga të cilat është kryer nëpërmjet bankës pagesa për pagën në shumën 441.280 lekë dhe janë paguar nga arka shpërblime plus dieta në shumën 558.720 lekë.

ii) Pagesat e likuiduara nga arka, të referuara nga shoqëria, nuk konfirmohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore - Drejtoria Rajonale Fier dhe Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, si dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj⁷⁴.

iii) Sipas librezës së punës, z. S. ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “{***}” ShPK për periudhën shtator 2010 e në vazhdim. Nga kontrata e punës [e datës 09.11.2010], e lidhur për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga data 1 shtator 2010, rezulton që paga mujore është 190.000 lekë, të cilat do të paguheshin së bashku me shpërblime e shtesa mbi pagë, sipas kontributit në punë. Sipas kontratës, punëdhënësi do t’i sigurojë të drejtat që burojnë nga ligji për sigurimet shoqërore. Më datë 17.09.2015, është lidhur kontrata e re e punës për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga data 1 shtator 2015 deri më datë 1 shtator 2020, me pagë mujore 50.000 lekë, me të njëjtat kushte sikurse kontrata e datës 09.11.2010. Sipas vërtetimeve të shoqërisë “{***}” ShPK⁷⁵, z. S. prej muajit shtator 2010 e në vazhdim është i punësuar pranë kësaj shoqërie dhe është paguar si më poshtë.

- o Për periudhën 01.09.2010 – 31.01.2011 – në shumën 150.000 lekë për çdo muaj dhe pagesa është kryer nëpërmjet bankës⁷⁶.

⁷⁰ Kjo vlerë është deklaruar edhe në deklaratën e interesave privatë për vitin 2006, si të ardhura nga “paga + shpërblime”.

⁷¹ Kjo vlerë është deklaruar edhe në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, si të ardhura nga “paga + shërbime + shpërblime”.

⁷² Kjo vlerë është deklaruar edhe në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008, si të ardhura nga “paga + shërbime + shpërblime”.

⁷³ Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2009 janë deklaruar të ardhura nga “paga + shërbime + shpërblime”, në vlerën 1.600.000 lekë.

⁷⁴ Shih poshtëshënimet nr. 54 dhe nr. 55.

⁷⁵ Vërtetime të datave 04.12.2014, 05.03.2015, 08.12.2018 dhe 21.03.2019.

⁷⁶ Sipas vërtetimeve të dy shoqërive, të ardhurat në total për vitin 2010 janë 1.600.000 lekë (1.000.000 lekë nga shoqëria “{***}” ShPK dhe 600.000 lekë nga shoqëria “{***}” ShPK.). Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2010, të ardhurat nga “paga, shërbimet, shpërblimet” të z. L. nga të dyja shoqëritë janë deklaruar në total 1.800.000 lekë.

- Për periudhën 01.02.2011 – 31.01.2012 – në shumën 37.824 lekë për çdo muaj, nëpërmjet bankës. Dietat dhe shpërblimet për punën e kryer në shumën 112.176 lekë për çdo muaj janë paguar nga arka e shoqërisë (1.800.000 lekë për të gjithë vitin 2011⁷⁷).
- Për periudhën 01.02.2012 – 31.12.2012 – në shumën 31.520 lekë për çdo muaj, nëpërmjet bankës. Dietat dhe shpërblimet për punën e kryer në shumën 118.480 lekë për çdo muaj janë paguar nga arka e shoqërisë (1.800.000 lekë për të gjithë vitin 2012⁷⁸).
- Për periudhën 01.01.2013 – dhjetor 2013 – për çdo muaj do të paguhet në shumën 40.000 lekë pagë bruto, pagë neto 31.520 lekë, pagesë e cila është kryer nëpërmjet bankës (378.000 lekë për të gjithë vitin 2013⁷⁹).
- Për vitin 2014 – të ardhurat neto i ka pasur 410.640 lekë⁸⁰.
- Për vitin 2015 – është paguar në shumën 41.640 lekë⁸¹.
- Për vitin 2016 – është paguar në shumën 68.440 lekë⁸².

iv) Të dhënat e pasqyruara nga shoqëria për të ardhurat në formën e shpërblimeve dhe/ose dietave nuk konfirmohen me të dhënat e përcjella nga institucionet, sikurse sigurime shoqërore dhe tatime. Sipas përgjigjeve nga këto dy institucione për muajt dhjetor 2011 – janar 2012, z. S. është paguar me pagë bruto 48.000 lekë dhe për periudhën shkurt 2012 e në vazhdim është paguar me pagë bruto 40.000 lekë për çdo muaj⁸³. Të dhënat mbi vlerën e pagës përputhen vetëm për periudhën shtator 2010 – janar 2011⁸⁴.

v) Vërehet se parashikimet e dy kontratave, respektivisht të lidhura në vitet 2010 dhe 2015, në trajtimin e punëmarrësit nuk kanë kuptim logjik. Konkretisht, ndërsa në kontratën e vitit 2010 deklarohet se punëmarrësi do të përfitojë pagë në vlerën 190.000 lekë, në kontratën e vitit 2015, periudhë kjo që presupozon se profesionalisht, për shkak të eksperiencës së fituar, punëmarrësi ka thelluar dhe forcuar aftësitë profesionale, paga e tij zbret në masë drastike, në vlerën 50.000 lekë. Kjo logjikë e përcaktimit të pagës bie ndesh edhe me zhvillimin ekonomik të tregut, pasi pagat nga periudha 2010 e deri në 2015, e më tej deri në vitin 2020, kanë tendencë rritjeje dhe jo uljeje, e gjithsesi jo në vlerën 3/4. Nga ana tjetër, konstatohet se ndërsa paga, për periudhën shtator 2010 – gusht 2015 do të duhet të ishte në vlerën 190.000 lekë (pa llogaritur shpërblimet dhe dietat) dhe për periudhën shtator 2015 – gusht 2020 do të duhet të ishte në vlerën 50.000 lekë (pa llogaritur shpërblimet dhe dietat), rezulton se nga ana e shoqërisë janë kaluar nëpërmjet bankës, për periudhën shtator 2010 – janar 2011, vlera neto 150.000 lekë për çdo muaj, më pas paga pasqyrohet në vlerën neto që i

⁷⁷ Vlerë e deklaruar edhe në deklaratën e interesave privatë për vitin 2011, si të ardhura nga “paga, shërbime, shpërblime”.

⁷⁸ Vlerë e deklaruar edhe në deklaratën e interesave privatë për vitin 2012 si të ardhura neto dhe është deklaruar edhe paga bruto 1.900.000 lekë.

⁷⁹ Vlerë e deklaruar edhe në deklaratën e interesave privatë për vitin 2013 si të ardhura neto dhe është deklaruar edhe paga bruto 40.000 lekë në muaj.

⁸⁰ Vërtetimi i shoqërisë i datës 05.03.2015. Kjo vlerë është deklaruar edhe në deklaratën e interesave privatë për vitin 2014.

⁸¹ Vërtetimi i shoqërisë i datës 21.03.2019. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2015, z. L. ka deklaruar të ardhura nga punësimi në shoqërinë “{***}” në vlerën 410.640 lekë.

⁸² Vërtetimi i shoqërisë i datës 21.03.2019. Kjo vlerë është deklaruar edhe në deklaratën e interesave privatë për vitin 2016.

⁸³ Sipas shkresave nga: Drejtoria Rajonale e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër, datë 19.11.2018; Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë, datë 05.02.2018 dhe datë 11.07.2017; Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, datë 17.12.2018; Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, datë 04.07.2017, datë 21.12.2018, datë 11.12.2018 dhe datë 13.12.2018, për periudhën shkurt 2011 – janar 2012, paga bruto është pasqyruar në vlerën 48.000 lekë në muaj dhe për periudhën shkurt 2012 e në vijim, paga bruto është pasqyruar në vlerën 40.000 lekë në muaj.

⁸⁴ Shkresa e datës 19.11.2018 e Drejtorisë Rajonale Gjirokastër, sipas së cilës, për periudhën shtator 2010 – janar 2011, paga bruto është pasqyruar në vlerat 190.355 lekë në muaj.

përket pagës bruto 48.000 lekë, duke zbritur në pagën bruto 40.000 lekë⁸⁵. Së fundmi, vihet re edhe që vërtetimet e shoqërisë – lidhur me përcaktimin e pagës bruto (për periudhën 2011 e në vijim) – nuk përputhen me parashikimet e kontratave.

vi) Në vijim dhe në përmbledhje të arsytimit të kryer më sipër, sa u përket të ardhurave të deklaruara të bashkëshortit të subjektit për vitet 2006 dhe 2007 më sipër [paragrafi 28 dhe nënparagrafët e tij], në kushtet kur vetëm një pjesë e pagesës nga shoqëritë është kaluar nëpërmjet sistemit bankar, kjo mënyrë veprimi nga të dyja shoqëritë, rrëzon pretendimin e subjektit të rivlerësimit se detyrimi për pagesat e pagave ka filluar të kryhet nëpërmjet sistemit bankar vetëm pas ndryshimeve ligjore të Kodit të Punës në vitin 2015. Vetë dinamika e pasqyruar sa më sipër, dëshmon qartë që pagesat e pagave nëpërmjet bankës janë kryer edhe më herët, në varësi të zgjedhjeve të drejtuesve të shoqërisë, dakordësuar me punëmarrësit. Përpos kësaj, pretendimet lidhur me pagesat e kryera nga punëdhënësi, nuk rezultuan bindëse për trupin gjykues, duke marrë në konsideratë që vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, është njohëse e legjislacionit, të cilin e ka parashtruar edhe në përmbajtjen e ankimit dhe të parashtrimeve, dhe kishte dijeni për detyrimet ligjore të punëdhënësit kundrejt buxhetit të shtetit. Ky vlerësim përforcohet edhe nga fakti që kontrata me “{***}” ShPK, pas vitit 2015 parashikon rënie drastike të pagesës së punës për bashkëshortin. Sjellim në vëmendje se bashkëshorti i subjektit në një periudhë kohore [2007-2010] ishte drejtues teknik punimesh për “{***}” ShPK, detyrë që e ka ushtruar edhe te shoqëria “{***}” ShPK. Së fundmi, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, dhe bashkëshorti i saj kryenin deklarime të të ardhurave në mënyrë vjetore periodike, saktësia e vlerave që pasqyroheshin merrte një rëndësi të veçantë, për plotësimin e saktë të deklaratave, në përmbushje të detyrimeve të ligjit nr. 9049/2003, por edhe në funksion të qasjes që duhet të kishte një zyrtar deklarues magjistrat ndaj ligjit.

vii) Duke abstraguuar se është fakt punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë shoqërive të ndërtimit, apo pozicioni i punës së tij (referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit), deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shumat të cilat ishin në formën e shpërblimit, mbetën të pavërtetuara dhe të pambështetura me dokumentacion provues. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për përfitimin e këtyre të ardhurave sipas vërtetimeve të shoqërive, nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare. Për shkak të efektit që kanë të ardhurat nga punësimi, sipas analizës së kryer në Kolegj, subjekti i rivlerësimit [dhe bashkëshorti] nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar gjendjet e llogarive bankare, shtesën e likuiditeteve *cash* dhe shpenzimet e kryera në vitet 2014 e 2015 me burime financiare të ligjshme. Kjo gjendje negative financiare do të rezultonte edhe në aplikim të çdo skenari të mundshëm garantist mbi të ardhurat e pretenduara nga punësimi i bashkëshortit, duke e vendosur subjektin në situatën e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme, për të mbuluar shpenzimet, shtesën në likuiditete dhe për të krijuar kursimet e deklaruara në vitet 2014 dhe 2015.

32.2.4. Për sa i përket mundësisë së krijimit të depozitës në emër të bashkëshortit, të çelur që në vitin 1988 pranë Bankës së Kursimeve (aktualisht Banka Raiffeisen), balanca e së cilës më 31.12.2016 është 4.944.662 lekë, informacioni mbi gjendjen dhe lëvizjet e depozitës fillon nga viti 2001, me balancë [në maj 2001] në vlerën 1.096.000 lekë. Në mungesë të informacionit për lëvizjet përpara kësaj date, Kolegji ka kryer analizë financiare për gjithë periudhën 1994 – 2001, për të analizuar mundësinë e krijimit të gjendjes që ka kjo depozitë më 31.12.2001. Duke marrë në konsideratë se pagesa e apartamentit në rrugën “{***}” [Tiranë], sipas kontratës, duhet të jetë shlyer deri në fund të vitit 2001, subjekti i rivlerësimit rezulton të mos ketë pasur mundësi financiare për të krijuar gjendjen që ka depozita në datën

⁸⁵ *Shih poshtëshënimin nr. 83.*

31.12.2001 – 1.148.854 lekë – me burime të ligjshme. Nga ana tjetër, në variantin e pretenduar nga subjekti – se apartamenti u pagua i gjithi në gusht 2007, në mosrespektim të kushteve të kontratës – subjekti do të kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet dhe shtesat në likuiditete për periudhën 1994 - 2001. Vlen të theksohet se mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme deri në vitin 2001, në variantin e pretendimeve të subjektit, gjithsesi nuk ndryshon sa ka rezultuar dhe është shtjelluar më sipër nga analiza financiare e viteve 2005-2007 për mungesë burimesh të ligjshme për të shlyer pagesën në gusht 2007 [shih paragrafin 27 dhe nënparagrafët e tij].

32.3.i. Shtesat prej rreth 3.800.000 lekësh nga viti 2001 deri në vitin 2016 në këtë depozitë, vijnë nga: a) të ardhurat nga interesat bankarë të gjeneruar nga kjo depozitë, të cilët janë rikapitalizuar në principalin e depozitës (në total rreth 1.500.000 lekë) vit pas viti; dhe b) dy depozitime *cash*, përkatësisht në vitet 2005 dhe 2010 (prej rreth 2.300.000 lekësh në total). Në këtë situatë transaksionesh, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni duhej të kryente verifikimin e mundësisë së krijimit të kësaj depozite nga kursimet familjare në vitin kur është çelur depozita dhe në vitet kur janë kryer depozitimet *cash*, si shtim në principalin e saj – konkretisht në vitet 2005 dhe 2010. Rezulton se Komisioni e ka trajtuar këtë depozitë si derivate të të ardhurave të bashkëshortit të subjektit për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Nga fashikulli, nuk duket të ketë rrethana faktike që mbështesin këtë qëndrim të Komisionit. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në situatën e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për gjendjen e dokumentuar më 31.12.2001.

32.3.ii. Nga ana tjetër, Kolegji konstaton se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme (nga puna e bashkëshortit në periudhën 1994 - 2016) në shumën 7.591.355 lekë, për të krijuar gjendjen në këtë llogari bankare [në pikën 8 të vendimit], nuk qëndron pjesërisht për dy arsye. Së pari, diferenca prej 7.591.355 lekësh është diferenca e të ardhurave të deklaruara nga subjekti me të ardhurat e konsideruara të ligjshme në analizën financiare dhe kjo jo detyrimisht është vlera e burimeve të pamjaftueshme për të krijuar depozitën. Ky konkluzion do të qëndronte nëse, si burim krijimi i depozitës, do të ishin deklaruar vetëm të ardhurat e përfituara nga këto dy shoqëri apo vetëm të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit, ndërkohë që nga aktet rezulton që burimi i deklaruar i kësaj depozite janë *kursimet familjare*. Së dyti, është e pabazuar në fakte apo logjikë që një vlerë pamjaftueshmërie për krijim depozite të tejkalojë vetë vlerën e depozitës në kohën objekt kontrolli apo më herët. Konkretisht, Komisioni është shprehur për pamjaftueshmëri në vlerën 7.591.355 lekë, ndërkohë që depozita objekt analize, më 31.12.2016, është 4.944.662 lekë. Në këtë total, vlerat të cilat janë objekt kontrolli për ligjshmërinë e burimeve përbëhen nga rreth 1.100.000 lekë gjendje në vitin 2001, 1.300.000 lekë shtuar në vitin 2005 dhe 1.000.000 lekë shtuar në vitin 2010.

32.3.iii. Në përfundim të sa më sipër, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezulton se subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar gjendjen e depozitës dhe kryerjen e shpenzimeve përkatëse në vitet 1994 – 2001, në totalin prej 7.218.415 lekësh. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka pasur pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme në vitin 2010, për të justifikuar shtesën e likuiditeteve në depozitën në fjalë dhe kryerjen e shpenzimeve përkatëse, në vlerën 513.959 lekë. Në konsideratë të mospërkeqësimit të situatës së subjektit si rezultat i ankimit, pamjaftueshmëria e burimeve financiare të ligjshme për të krijuar pasuritë dhe kryer shpenzimet, përfshirë edhe periudhën deri në vitin 2001, konstatuar nga Komisioni, qëndron.

33. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se, për sa i përket gjendjes cash dhe analizës financiare për periudhën 2005 – 2016 [pikat 9 dhe 10 të vendimit], Komisioni nuk përfshin balancat*

pozitive të viteve 2011 dhe 2016. Për balancat negative për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2012, subjekti pretendon se Komisioni nuk i ka dhënë analizë financiare, duke i mohuar mundësinë për të kundërshtuar rezultatet. Subjekti i rivlerësimit argumenton se, nëse do të ndryshoheshin vetëm të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit, sipas deklarimeve, rezultati do të ishte pozitiv në vlerën totale 3.638.309 lekë për vitet 2005 – 2010 dhe 2012 – 2015. Komisioni gabon kur e trajton analizën financiare si një instrument ekzakt, duke konsideruar shkelje edhe vlerën negative 8.057 lekë.

33.1. Si rezultat i analizës financiare, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen e kursimeve *cash* të deklaruara në periudhën 2005 – 2015, si burim për krijimin e depozitës bankare pranë bankës BKT-së, si dhe gjendjen e mbetur të kursimeve *cash* në banesë, prej 1.200.000 lekësh. Sipas kësaj analize, subjekti rezultoi me një balancë negative të fondeve në shumën prej 5.896.320 lekësh.

33.1.i Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit që analiza financiare të përfshijë edhe të dhënat e viteve me rezultat pozitiv, nuk qëndron. Analiza bazohet në kombinimin e standardeve minimale të jetesës me shpenzimet e tjera të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato që konfirmohen nga dokumentacioni. Në dritën e detyrimeve që ka pasur subjekti sipas ligjit nr. 9049/2003 ndër vite, në vitet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesë në kursimet *cash*, deduktohet në përputhje me deklaratën periodike vjetore⁸⁶ se subjekti nuk ka pasur kursime. Ky deduksion vlen edhe nëse nga analiza rezulton me diferencë pozitive mes të ardhurave të ligjshme dhe totalit të shpenzimeve jetike dhe/ose të deklaruara për një vit të caktuar, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesë në kursimet *cash*. Si rrjedhojë, një shifër teorike, apo e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, nuk mund të mbartet në analizë për vitet e ardhshme dhe as në rezultatin financiar të periudhës për subjektin, për sa kohë nuk është deklaruar kursim nga subjekti në kohën kur pretendohet se është krijuar. Për këto arsye, qëndrimi i Komisionit ka qenë i drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë deklarimin e pasurisë dhe me jurisprudencën e Kolegjit⁸⁷.

33.1.ii. Pretendimi mbi të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për të cilat nuk vërtetohet pagesa me dokumentacion ligjor, është trajtuar gjërisht në paragrafët 28 e 32.2.3 dhe nënparagrafët e tyre, të këtij vendimi.

33.1.iii. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mungesë mundësie për të kundërshtuar analizat financiare të viteve 2008, 2009, 2010 dhe 2012, sikurse është trajtuar edhe në paragrafët 18.1 dhe 18.2 të këtij vendimi, nuk qëndron dhe është i pabazuar.

33.1.iv. Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, rezulton se gjendja e akumuluar e kursimeve *cash* në fund të vitit 2016, sipas shtesave dhe pakësimeve të deklaruara nga subjekti ndër vite në deklaratat periodike vjetore, rezulton të jetë 6.645.560 lekë⁸⁸. Kjo nënkupton një mospërputhje të gjendjes së kursimeve *cash* në fund të vitit 2016 prej 1.245.560 lekësh [6.645.560 – 4.200.000 – 1.200.000]. Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, rezulton se

⁸⁶ Neni 32, pika 5 e ligjit parashikon që “[...] 5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.”

⁸⁷ Shih, ndër të tjera, vendimet e Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. A. Xhoxhaj [JR nr. 09/2018], subjektit të rivlerësimit Xh. Zaganjori [JR nr. 19/2019], subjektit të rivlerësimit E. Sadiku [JR 07/2019].

⁸⁸ Kjo shifër ndryshon nga analiza e Komisionit me 816.000 lekë, nga të cilat 350.000 lekë përbëjnë shpenzim për udhëtime, deklaruar nga subjekti në vitin 2015, ndërsa 466.000 lekë përbëjnë vlerën e deklaruar si shpenzime mobilimi në vitin 2016. Komisioni ka pakësuar kursimet për këto dy shpenzime, megjithëse nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar se këto shpenzime janë kryer nga kursimet.

subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare ndër vite për të krijuar gjendjen e akumuluar të *cash*-it në banesë, në fund të vitit 2016, prej 1.200.000 lekësh dhe, për pasojë, edhe për krijimin e depozitës prej 4.200.000 lekësh në janar 2017⁸⁹. Në këtë përlogaritje të gjendjes reale të *cash*-it të akumuluar, nuk përfshihet pakësimi prej 1.500.000 lekësh i kursimeve të deklaruara nga subjekti në vitin 2007 për blerjen e apartamentit, në kushtet kur pretendimi i subjektit se apartamenti është paguar në gusht të vitit 2007, mbetet i paprovuar me dokumentacion dhe në nivel deklarativ⁹⁰. Edhe në hipotezën e parashtruar më sipër [paragrafi 32.2.3, pika vii)], për të shteruar edhe alternativën e parashtruar nga subjekti për pjesën e të ardhurave të padokumentuara nga punësimi i personit të lidhur, edhe pse ndryshohen këto të dhëna në kahun pozitiv, gjithsesi subjekti i rivlerësimit rezulton se gjendet në situatën e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme, minimalisht për të mbuluar shpenzimet, shtesën në likuiditete dhe për të krijuar kursimet e deklaruara në vitet 2013, 2014 dhe 2015.

34. *Sipas subjektit, edhe po të merrej e mirëqenë analiza financiare e Komisionit, e cila konkludon me një diferencë negative fondesh në shumën 5.896.320 lekë apo me një diferencë prej 7.591.355 lekësh, si rezultat i vlerësimit si burime të paligjshme të të ardhurave nga paga (1 nga 2 variantet, jo totali), përsëri nuk ndodhet në situatën e dyfishit të pasurisë totale, duke qenë shumë larg kësaj gjendjeje, sipas nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.*

34.1. Siç është shtjelluar gjerësisht më sipër, në pjesën e arsytimit që u përket shkaqeve me natyrë procedurale, Komisioni ka vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për shkak se subjekti rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë dhe me deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm. Masa disiplinore për deklaram të më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të, parashikohet nga neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Kjo dispozitë ligjore dhe ky prezumim i mundshëm shkeljeje nuk gjendet i artikuluar nga Komisioni në vendimin nr. 139, datë 15.04.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit. Nga ana tjetër, sikurse ka rezultuar edhe nga analiza financiare e kryer në Kolegj, për periudhën 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe investimet në pasuri të luajtshme e të paluajtshme, si dhe gjendjen e likuiditeteve në bankë apo *cash*, çka sjell aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

35. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, në lidhje me pasurinë likuiditete jashtë sistemit bankar dhe likuiditeteve në bankë, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të krijuar gjendjet e deklaruara, duke rezultuar me mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*C.4. Lidhur me pasurinë e paluajtshme tokë bujqësore, me sip. 2,2 dynym, në emër të z. M. S., e përfituar me ligjin nr. 7501, “Për tokën”, me aktin nr. {***}, të marrjes së tokës në pronësi*

⁸⁹ Deklaruar në deklaratën vetting.

⁹⁰ Komisioni, në analizën financiare, e ka konsideruar sikur blerja e apartamentit ka ndodhur në vitin 2007, njëkohësisht ka përlogaritur mungesë burimesh në vlerën 5.289.892 lekë (pa përfshirë shpenzimet e jetesës) deri më 31.12.2001 – sipas kontratës së porosisë dhe konstatimit që apartamenti ka qenë në posedim të subjektit që në vitin 2002. Nëse ndiqet kjo logjikë e Komisionit, për t’iu përgjigjur edhe kërkesës së subjektit për të mbajtur një qëndrim, përlogaritja e pagesës së apartamentit brenda vitit 2001, do të sillte rezultatin e mësipërm.

36. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit për deklarim të pasaktë është i gabuar, pasi familja bujqësore me kryefamiljar M. S. ka përfituar tokë arë në sasinë e caktuar në deklaratën vetting, gjithsej 2200 m² dhe jo 2400 m². Mospasqyrimi i kësaj pasurie në deklaratën e interesave privatë në vitin 2003 ka ndodhur për shkak se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë jetuar në fshat pas martesë dhe se nuk e kanë përdorur apo përfituar të ardhura nga kjo pasuri, çka e përjashton mundësinë për mospasqyrim të qëllimshëm. Nuk ka asnjë përpjekje për të fshehur ose për të paraqitur në mënyrë të pasaktë këtë pasuri në bashkëpronësi të bashkëshortit me anëtarët e tjerë të familjes bujqësore, të përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 7501/1991”). Për të argumentuar këtë pretendim, subjekti mbështetet në arsyetimin e Komisionit në vendimin nr. {***}, datë 24.07.2018⁹¹.*

36.1 Nga aktet e administruara nga Komisioni, konstatohet se me aktin e marrjes së tokës në pronësi të datës 28.02.1994, Komisioni i Ndarjes së Tokës së fshatit {***}, të rrethit Tepelenë, i ka dhënë në pronësi babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, M. S., gjithsej 2200 m², të ndarë në dy ngastra toke, e cila ende nuk është regjistruar, pasi nuk ka nisur regjistrimi fillestar i pasurive në fshatin {***}. Nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Këshilli i Qarkut Gjirokastër, me shkresën e datës 14.01.2019⁹², jepet informacion se L. S. ka përfituar tokë në bazë të ligjit nr. 7501/1991, në masën 550 m². M. S. ka përfituar 550 m² dhe Sh. S. [vëllai] ka përfituar 1300 m². Me shkresën e datës 19.03.2019⁹³, e njëjta strukturë jep informacion se familja e z. M. S. është trajtuar si familje bujqësore më vete dhe ka përfituar 2200 m² tokë arë dhe se z. L. S. ka përfituar 550 m² tokë arë (M. S. ka përfituar 550 m², T. S. ka përfituar 550 m² dhe Sh. S. ka përfituar 550 m²), ndërsa Sh. S. [vëllai] është trajtuar si familje bujqësore më vete dhe ka përfituar gjithsej 1300 m² tokë arë. Bashkëlidhur gjenden vërtetimet e datës 19.03.2019, si dhe AMTP-ja në emër të z. M. S. për dhënien në pronësi të 2200 m² tokë arë dhe AMTP-ja në emër të z. Sh. S. për dhënien në pronësi të 1300 m² tokë arë. Sipas shkresës së ZVRPP Tepelenë, të datës 18.03.2019, z. M. S. nuk ka të regjistruar truall dhe banesë, pasi fshati {***} nuk ka kaluar në proces regjistrimi fillestar. Bashkia Tepelenë, më datë 13.12.2018⁹⁴, i ka kthyer përgjigje Komisionit, ku ndër të tjera e informon se familja S. ka përfituar në bazë të ligjit nr. 7501/1991, tokë me sipërfaqe 2200 m², duke i bashkëlidhur AMTP-në dhe certifikatën familjare në datën 01.08.1991. Sipas kësaj të fundit, familja e z. M. S. ka pasur në përbërje 4 pjesëtarë (M. S., T. S., L. S. dhe Sh. S.).

36.2. Nga shqyrtimi i deklaratave të interesave privatë, konstatohet se kjo pasuri nuk është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë për vitin 2003, duke u deklaruar për herë të parë në deklaratën *vetting* (në masën 25%). Ndërkohë rezultojnë se z. L. S. i takon, si pjesë nga kjo sipërfaqe, 550 m², pra 25% e sipërfaqes prej 2200 m², referuar sipërfaqes së AMTP-së në emër të z. M. S. dhe numrit të pjesëtarëve të familjes në vitin 1991. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha, janë pjesërisht të pabazuara pasi bashkëshorti dhe, për rrjedhojë, ajo kishin detyrimin ligjor të deklaruarin çdo pasuri në pronësi, përdorim apo posedim. Nga ana tjetër, nuk qëndron vlerësimi i Komisionit se subjekti ka dhënë deklarim të pasaktë mbi sasinë e tokës që ka përfituar, pasi nga dokumentacioni rezultojnë se pjesa takuese e z. L. është 550 m², pra ¼ e sasisë 2200 m². Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo pasaktësi e subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk pretendon të ardhura nga kjo pasuri, nuk konsiderohet mjaftueshëm me peshë në atribuimin e pasojave disiplinore vetëm për këtë pasuri.

⁹¹ <https://kpk.al/subjekti-z-xhezair-zaganjori-gjyqtar-kryetar-i-gjykates-se-larte/>

⁹² Nr. {***} prot.

⁹³ Nr. {***} prot.

⁹⁴ Nr. {***} prot.

C.5. Lidhur me gjetjen e Komisionit për ushtrimin e aktivitetit të bashkëshortit si ekspert topograf në gjykatë.

37. *Subjekti i rivlerësimit parashtron se bashkëshorti është thirrur nga gjykata si ekspert, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurës Civile, dhe se zgjedhja e ekspertit është në diskrecionin e gjyqtarëve. Thirrja e bashkëshortit nga gjykata nuk është e shpeshtë; kryesisht ka qenë i thirrur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, duke qenë i përfshirë në listën e ekspertëve të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës, për periudhën 2016 - 2019. Licencat e depozituara në kancelarinë e gjykatës përcaktojnë fushën e ekspertizës dhe njohuritë profesionale. Bashkëshorti i saj është paguar nga pala paditëse, kur është thirrur për të dhënë sqarime plotësuese për një akt të kryer më parë për llogari të gjykatës. Është derdhur tatimi në burim, e provuar nga aktet e paraqitura në Komision. Caktimi i bashkëshortit si ekspert është bërë me vendim të ndërmjetëm të gjykatës; në asnjë rast palët nuk kanë pasur pretendime me caktimin e tij apo të kenë vënë në diskutim licencimin apo kualifikimin profesional të tij. Subjekti sqaron se bashkëshorti ka kryer ekspertimet i vetëm, me përjashtim të dy rasteve kur ekspertimi është kryer me ekspertë të tjerë. Bashkëshorti nuk ka pasur asnjëherë detyrimin për t'u regjistruar pranë organit tatimor pasi nuk ka kryer asnjëherë aktivitet tregtar, duke zgjedhur të punësohet pranë një subjekti privat. Të ardhurat nga aktet e ekspertimit zënë një përqindje shumë të vogël të të ardhurave të tij në total. Bashkëshorti ka deklaruar përpara gjykatës se është person i licencuar, por i paregjistruar në tatime dhe se për të ardhurat që përfiton nga kryerja e ekspertimit paguan tatim në burim; vetë gjykatat e kanë vlerësuar të rregullt procedurën dhe kanë lejuar kryerjen e ekspertimit. Mospasqyrimi i shumës së marrë për aktin e ekspertimit të kryer për një çështje [të vitit 2016] për të cilën është mbajtur tatimi në burim, ka ndodhur për shkaqe harrese, por kjo shumë ka kaluar në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortit dhe ka qenë e përfshirë në shumën e deklaruar në deklaratën periodike.*

37.1. Lidhur me këtë gjetje, Komisioni ka konkluduar se personi i lidhur me subjektin ushtron aktivitet si ekspert topograf në gjykatë, në shkelje të legjislacionit tatimor, pasi ka përfituar të ardhura nga ofrimi i shërbimit të ekspertizës topografike pa u regjistruar rregullisht në organet tatimore. Subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, nuk i ka deklaruar të ardhurat nga ekspertizat në gjykatë gjatë vitit 2016 dhe, si pasojë e qasjes personale të saj, në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit tatimor, ka rezultuar krijimi i situatave në shkelje të këtij legjislacioni dhe të kodeve procedurale, lidhur me mënyrën e dhënies së shërbimit të ekspertizës topografike në gjykatë nga personi i lidhur.

37.2. Nga shqyrtimi i të dhënave të administruara, konstatohet se në përgjigjet e dhëna më datë 22.01.2019, subjekti i rivlerësimit, znj. Albina Spaha, ka informuar Komisionin se bashkëshorti i saj është thirrur me cilësinë e ekspertit topograf në disa gjykime; është pajisur me licencë, nuk është regjistruar në organet tatimore dhe për të ardhurat e përfituara nga ekspertimet e kryera, është paguar në burim në masën 15%. Në përgjigje të pyetjes së Komisionit, nëse bashkëshorti i saj është thirrur në cilësinë e ekspertit pranë gjykatës ku ajo kryen funksionin e gjyqtarës/kryetarës dhe nëse ka qenë në konflikt interesi, subjekti ka dhënë informacion se në vitin 2018 është caktuar për gjykimin e një çështjeje civile dhe se duke qenë se midis palëve ndërgjyqëse ishte zhvilluar një gjykim në gjykatën administrative dhe akti i ekspertimit për atë gjykim ishte kryer nga bashkëshorti i saj, i ka kërkuar kryetarit të Gjykatës së Apelit heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje. Kërkesa është pranuar dhe ajo është zëvendësuar nga një gjyqtar tjetër. Sipas subjektit, ka vlerësuar që bashkëshorti të mos marrë pjesë në gjykime të zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Komisioni i ka kërkuar opinion ILDKPKI-së duke shtruar pyetjet nëse subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, në kushtet kur bashkëshorti i saj ofron shërbime të ekspertimit

në tri gjykata me seli në Gjirokastrë (Administrative të Shkallës së Parë, të Rrethit Gjyqësor dhe të Apelit) dhe i paregjistruar në organet tatimore. ILDKPKI-ja⁹⁵ është shprehur se nuk provohet që subjekti i rivlerësimit të ketë ushtruar funksionin publik në kushtet e konfliktit të interesave. Nga shqyrtimi i deklaratës së interesave privatë për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ardhura nga shërbimi i ofruar nga bashkëshorti si ekspert.

37.3. Trupi gjykues Kolegjit vëren se në vitin 2016 (deri më datë 27.01.2017⁹⁶), nuk ka pasur rregullime të detyrueshme për thirrjen në gjykatë vetëm të ekspertëve të regjistruar pranë organeve të tatimeve. Thirrja e ekspertëve të regjistruar dhe që kanë përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet tatimore, është bërë e detyrueshme me ndryshimet ligjore të Kodit të Procedurës Civile në vitin 2017⁹⁷. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se për shërbimet e ofruara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, janë paguar detyrimet tatimore në burim. Po kështu, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë thirrur në çështjet e gjykuara prej saj, bashkëshortin në cilësinë e ekspertit, çka përjashton mundësinë e një konflikti interesi në dukje. Mungesa e konfliktit të interesit është përjashtuar edhe nga ILDKPKI-ja në interpretimin që u ka bërë të dhënave të rastit në raport me parashikimet e ligjit nr. 9367/2005. Po kështu, nga analiza financiare e kryer si në Komision, ashtu edhe në Kolegj për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton në kushtet e pamjaftueshmërisë të burimeve financiare të ligjshme për këtë vit. Nga ana tjetër, vërehet se pavarësisht konstatimeve dhe konkluzioneve mbi këtë gjetje, Komisioni nuk e ka adresuar këtë çështje në ndonjë nga situatat që e ngarkon subjektin me përgjegjësi disiplinore në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

37.4. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, duke pranuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerëson se në analizë të tërësisë së aspekteve të këtij shkak ankimi, pasaktësia e subjektit të rivlerësimit lidhur me mosdeklarimin e të ardhurave nga shërbimi që ofron personi i lidhur, nuk konsiderohet me mjaftueshëm peshë në atribuimin e pasojave disiplinore vetëm për këtë gjetje.

- 38.** Trupi gjykues i Kolegjit në përfundim, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerëson se:
- i) Në lidhje me pasurinë apartament, me sipërfaqe 121,8 m², të ndodhur me adresë në rr. “{***}”, Njësia nr. {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
 - ii) Në lidhje me pasurinë automjet, tip “Toyota Rav. 4”, blerë në shumën 906.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
 - iii) Në lidhje me pasurinë likuiditete në formën e gjendjes *cash* dhe likuiditete në bankë përgjatë periudhës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të krijuar gjendjet e deklaruara, duke rezultuar me mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- 39.** Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë për shkak se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit nr. 139, datë 15.04.2019, është i drejtë, i bazuar në prova dhe ligj e duhet të lihet në fuqi.

⁹⁵ Shkresa nr. {***} prot., datë 23.01.2019.

⁹⁶ Data e dorëzimit të deklaratës vetting.

⁹⁷ Miratuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, hyrë në fuqi në nëntor 2017.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 139, datë 15.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Albina Spaha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 12.01.2021.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi